




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, info.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Procesverbal

I mbajtur në Seancën e njëmbëdhjetë (XI) të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, më datë 6.11..2014 me këtë:

R E N D P U N E

- 1** Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar
- 2 Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**
 - 2.1 Vendimi për transferim dhe ridestinimin e mjeteve financiare
 - 2.2 Raporti financiar Janar-Shtator 2014
 - 2.3 Statuti për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Gjilanit 01.Nr.53125 të datës 11.11.2011
 - 2.4 Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Gjilanit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2013
 - 2.5 Kompensimi i borxhit në emër të shpenzimeve të rrymës dhe të ujit të shkaktuara në objektin e Feim Zylfiut sipas kontratës mbi qiranë nr.02.14782 të datës 15.11.2010
 - 2.6 Kompensimi i borxhit Organizatës së Pensionistëve dhe Invalidëve të punës sipas Marrëveshjes së Mirëkuptimit, 02.Nr.149 të datës 29.03.2010
 - 2.7 Informatë e punës e KKSMB Mars-Shtator 2014

3 Të ndryshme

Seanca e Kuvendit i filloi punimet në ora 10.00

Në punimet e seancës së 11 (njëmbëdhjetë), morën pjesë:

Anëtarët e Kuvendit

Kryetari i Komunës, z. Lutfi Haziri

Përfaqësuesi i OSB-së

Përfaqësuesi i Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, Fazli Abdullahu
Përfaqësuesi i Shoqërisë Civile, Shaban Terziu
Përfaqësuesi i OJQ “Anamorava”, Isa Shefkiu
Mediet.

Seancën e njëmbëdhjetë e hapi dhe udhëhoqi, kryesuesja e Kuvendit e cila fillimisht kërkoi që të konstatohet prezenca së anëtarëve të Kuvendit në seancën e njëmbëdhjetë.

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Nga ana e sekretarisë u konstatua se në punimet e seancës së njëmbëdhjetë ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit.

Para se të aprovojmë rendin e punës dhe procesverbalin e kemi një kërkesë nga Këshilli i Zhegrës që ta aprovojmë vendimin: Për lejimin e vendosjes së Memorialit “KATANA”. Të gjithë shefat e grupeve janë pajtuar që edhe kjo pikë të hyjë në rend të punës, prandaj kërkoj që edhe kjo pikë të aprovohet në KK. Kjo pikë të shqyrtohet si e para, sepse dhuruesi është këtu, por i duhet të largohet sa më parë, sepse ka një udhëtim zyrtar.

Aprovohet kërkesa e Këshillit të Zhegrës : Vendim për lejimin e vendosjes së Memorialit “KATANA” me 28 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerat ishin abstenime.

Sahit Abazi- ne në KPF, kemi kërkuar që në seancën e radhës të hyjnë edhe tri pika të rendit të punës; 1. Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor, 2. Ndërtimet pa leje (informatë) 3. Punësimet me kontratë në vepër. Për pikën e tretë ndoshta nuk ka mundësi të epet sot informatë, sepse drejtori aktualisht është në paraburgim, por dy të parat kërkojmë që të hyjnë në rend të punës.

Valentinë Bunjaku Rexhepi- sa i përket informatës për fillim të vitit të ri shkollor DKA ka dhënë informatë në seancën e kaluar dhe kështu e kam thënë edhe në KPF. Për punëtorët e punësuar me kontratë në vepër do t’iu dërgohet informata me shkrim, kurse për ndërtimet pa leje sot është e pamundur të epet informatë.

Sahit Abazi- ju nuk po na raportoni gojarisht në Kuvend kur po kërkohet diçka, kurse me shkrim PDK ka bërë shumë kërkesa, por ju nuk keni dhënë përgjigje. Ne jemi këtu për debat dhe e dimë rolin tonë dhe nuk do të lejojmë devijime nga ligji dhe paqartësi të shumta që po ndodhin. Këto tri pikë të rendit të punës ka kohë të gjatë që po i kërkojmë, por edhe pse ka kaluar muaji i nëntë i qeverisje ju përsëri nuk i keni sjell. Mund të mos i sillni këto informata, por rrezikon që Komuna e Gjilanit të jetë më jo transparentja në Kosovë. Këtë po bëni qëllimshëm, sepse nuk iu kushton asgjë për t’i sjell këto informata në Kuvend dhe për të lejuar debat në Kuvend. Duhet ta keni që qartë, se po bëni Komunën më diskriminuese në Kosovë.

Bujar Nevzadi- ne kemi kërkuar informatën me shkrim në seancën e kaluar, por për shkak të fajit të juaj që jeni vonuar 40 minuta, ne opozita e kemi lëshuar seancën dhe kemi kërkuar që në këtë seancë të jetë informata. Mirëpo nuk është e vërtetë që drejtori i Arsimit ka dhënë informatë. Qytetarët e Gjilanit po e dinë se çka po ndodh në Komunë të Gjilanit dhe nuk keni nevojë të fshihni asgjë, prandaj kërkoj që të futet në rend të punës: Informata për fillim të vitit të ri shkollor, sepse kaluan 9 muaj dhe asnjë pikë të rendit të punës të cilën e ka propozuar opozita ju nuk e keni fut në rend të punës. Nën dy kërkojmë informatë për ndërtimet pa leje dhe nën tre formimin e një komisioni për verifikimin e projekteve. 4. Kërkojmë një informatë zyrtare për humbjen tragjike të maturantit gjatë ekskursionit në Durrës, sepse kaluan 2 muaj dhe ne nuk kemi

informatë. Mandej kërkojmë informatë pse drejtori i Arsimit nuk ia ka kthyer mjetet (parat) nxënësve, sepse ekskursioni për këtë rast tragjik është ndërprerë në gjysmë.

Valentinë Bunjaku Rexhepi- ne keni dhënë informatë për fillim të vitit shkollor, por ju e keni lëshuar seancën. Sa i përket kërkesave tjera do t' i keni në adresat e juaja elektronike në çastin kur drejtorët i përgatisin këto informata.

Bujar Nevzadi- nuk ka nevojë kryesuesja të na hedh hi syve, ajo për shkak se është implikuar në çështje të arsimit po mundohet që të na hedh hi syve. Urdhëro fute në rend të punës, bisedojmë, por ju zonja kryesuese je implikuar në kompetenca të arsimit dhe nuk po lejon që të futet në rend të punës. Nuk është e vërtetë se drejtori i Arsimit ka dhënë një informatë rreth fillimit të viti shkollor.

Fatbardhë Selmani – kërkoj që në rendin e punës të futet edhe debati për gjendjen e shëndetësisë, sepse në këtë sektor gjendja është shumë e rëndë dhe çdo ditë e më tepër po rrezikohet gjendja shëndetësore e qytetarëve të Gjilanit e sidomos e nxënësve dhe personelit shëndetësorë në ambulanca. Për këtë kemi raporte të sakta dhe informata për këtë që po e themi.

Riad Rashiti- unë e kam një lutje, sepse kanë kaluar pesë seanca që kërkoj informata me shkrim, por ju nuk jepni përgjigje. Unë dhe grupi i ynë deri më tash i kemi dërguar 75 kërkesa dhe prej tyre për 48 nuk kemi marrë përgjigje. Arsyeja se do të epen përgjigjet në email nuk qëndron, sepse ju si kryesuese në shtatë kërkesa nuk jeni përgjigj. Kryetarit të Komunës 12 kërkesa ia kemi dërguar me shkrim asnjëherë nuk është përgjigj. Katër kërkesa kanë qenë për qasje në dokumente zyrtare , por nuk e kemi marrë asnjë përgjigje. Kjo është papërgjegjësi, por përveç kryetarit dhe kryesuese edhe shumica e drejtorëve nuk na japin përgjigje me përjashtim të drejtorit të Shërbimeve Publike i cili është jashtëzakonisht i përgjegjshëm dhe na është përgjigj në afatin e duhur.

Ne kemi kërkuar edhe me shkrim që në këtë seancë të debatohet për ndërtimet pa leje, sepse kjo është çështje serioze dhe janë mbi 55 ndërtime pa leje të cilat ne i kemi evidentuar. Janë me mijëra katror objekte që ndërtohen shumë afër shtëpisë së kryetarit dhe zyrës së tij të punës.

Ne me çdo kusht kërkojmë që kjo çështje të hyjë në rend të punës. Ne kemi edhe informacione se Gjilani është shndërruar në investitorë të jabanxhive, sepse janë kolegët e tij deputet që vijnë dhe investojnë në Gjilan. Rrënohen fabrikat e bukës, dje ka filluar rrënimi i Fabrikës së Duhanit . Objektet e privatizuara po shndërrohen në zona ndërtimi, kjo është e patolerueshme dhe ne kërkojmë debat në këtë seancë.

Kam pyetje pse po mbahet sekret Raporti i vlerësimit të vërshimeve? Keni deklaruar se 1 milion e 600 mijë euro dëme, kurse ju këtë po mbani sekret. A ka dikush që ep përgjigje pse po e mbani sekret? Mos tentoni ta mbani sekret, sepse nuk mund ta mbani, ka kaluar koha e vitit 2002 kur keni vepruar se keni dashur me rastin e tërmetit të atij viti.

Mandej pse po ndërhyjnë në punët e Zyrës së Prokurimit? Janë dy raste kur OSHP ka konstatuar se kryetari i Komunës ka ndërhyrë në procedura të prokurimit për të dhënë tender. Tjetra pse po i rrezikoni dhuruesit edhe grandet e KE-së për shkak të ndërhyrjes ? Ka pesë muaj që zgjat një procedurë e prokurimit, kjo ka ndodhur se tenderin ia keni dhënë kompanisë së juaj më të preferuar, kurse OSHP-ja ka ndërhyrë dhe e ka anuluar dhe iu ka detyruar që kompanisë 4 ia keni dhënë që ka qenë më i lirë, i keni tejkaluar tri kompani të përgjegjshme. Komuna është shndërruar në biznes nuk është më Komunë. Nga Zyra e Personelit na ka informuar se 33 punëtorë janë me kontratë në vepër, kurse ju na keni dhënë përgjigje se janë vetëm 13! Pse po i mbani 20 punëtorë sekret dhe nuk i paraqitni publikisht? Në Zyrën e kryetarit të Komunës, ka punëtorë që punon dhe nuk ka as kontratë në vepër dhe as në ndonjë kompani dhe është zyrtar i lartë i cili i viziton drejtoritë dhe i merr në pyetje zyrtarët për punën e tyre. Pse po e keqpërdorni buxhetin e Komunës, kurse i keni shpenzuar 32 mijë euro për blerjen e kombit për bartjen e personave për trajtim në dializë. Kanë kaluar 4 muaj dhe ky kombi asnjë ditë nuk është shfrytëzuar për personat që trajtohen në dializë?

Të sëmurit i futni në një automjet tjetër i cili është vetëm për një pacient, kurse aty barten 6-7 pacientë. Kjo është dhunë ndaj pacientëve në dializë.

Në fund kërkojmë informatë: për dëmet dhe vërshimet, për çështje të prokurimit të cilat i ngrita dhe kërkoj nga kryetari i Komunës pse nuk e ka sjell raportin 6 mujor të punës, sepse është i obliguar që ta paraqes raportin e punës në çdo 6 mujor.

Fehmi Sylejmani- ne kemi kërkuar informatë nga drejtori i Arsimit për fillim të vitit shkollor dhe prej asaj kohe ka kaluar shumë kohë dha kanë kaluar shumë zhvillime të cilat gjithsesi drejtori të na jep informatë. Mirëpo po iu bëj me dije se atë që e votuat paraprakisht për kompleksin Memorial në Zhegër është jashtë ligjore. Nuk është ky rast urgjent dhe duhet patjetër të aprovet dhe më mirë ka qenë të shtyhet për një javë të përgatitet mirë materiali dhe mandej ta propozoni për votim. Në këtë rast keni bërë shkelje ligjore.

Shukrie Rapuca- edhe unë e kam një çështje për të ndryshme për drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë e cila pyetje ka të bëjë me atë se çka është ndërmarrë lidhur me eliminimin e qenve endacak e të cilët janë kërcënim për qytetarët, por sidomos për nxënësit të cilët shkojnë në shkollë herët në mëngjes.

Lutfi Haziri- iu përshëndes juve anëtarë të Kuvendit dhe të gjithë të tjerët, por fillimisht po e them se nuk e kam ndërmend për ta ngarkuar rendin e punës më tepër se sa është paraparë për esencën e sotme. Jam i gatshëm çdo iniciativë për ta diskutuar sidomos nga radhët e opozitës ta debatojmë qoftë sot qoftë në seancën e radhës, sepse po hyjmë në tre mujorin e fundit dhe ky tre mujor tregon që edhe ndërmarrjet komunale dhe të gjithë përfituesit buxhetor që kanë përgjegjësi ndaj Komunë kanë përgjegjësi në Kuvend.

Ne jemi njerëz, ka mundësi edhe të gabojmë, po në momente që implikohesh në privatësi të dikujt dhe akuzon për diçka që nuk është e vërtetë, atëherë duhet të ballafaqohemi me të vërtetën.

Te Fabrika e Radiatorëve nuk ka banim, po për atë fabrikë jam akuzuar nga një këshilltar komunal se gjëja jam i involvuar dhe që eulexi po bën hetime ndaj meje. Mirëpo këto gjëra janë vërtetuar dhe tani shtrohet pyetja ku mbetën ato akuza të pabaza dhe është vërtetuar se nuk ka të bëjë asgjë me të vërtetën. Mua me vjen keq, por njerëzit do të ballafaqohen me vlerësim, kurse ne punojmë në mënyrën tjetër dhe angazhimi i jonë është që të thjeshtësohet puna. Sot statuti ose do të votohet ose jo, këtë e vendosni ju, por administrata do të organizohet dhe riformatohet, por në bazë të punëve dhe objektivave që janë realizuar. Ne me grupet e këshilltarëve jemi të gatshëm t' i debatojmë të gjitha çështjet të cilat janë në interes dhe t' i japim zhvillim.

Është pak më urgjentë memoriali i KATANES në Zhegër edhe si emër edhe si termë, është projekt të cilin Këshilli i fshatit Zhegër e ka iniciuar, por i cili nuk ka edhe ndonjë impakt të rëndë buxhetor, por e ka një iniciativë për ta hapur një teatër të hapur ku aktivitet që lidhen me ditët e Agimit, me respektin ndaj një dëshmorit, të nderohet dhe të zhvillohen aktivitete. Aty është një tokë kodrinore, por ne jemi të interesuar ta kthejmë në një kodër të respektimit, të respektit për heronjtë dhe dëshmorët e kombit.

Sa i përket grandeve të gjitha aplikacionet prej janarit të këtij viti i ka kërkuar në KE- janë realizuar 100%. Kosovën e Bukur e kemi fituar për lagjen "Dardania", programin e EUREDIT që bartës është Komuna dhe CERIT i cili është një program i KE dhe Komunës i cili e prek sektorin e bujqësisë. Në programin për bashkëpunim ndërkufitar, bartës jemi ne dhe Komuna e Çairit të Çarshia e Vjetër dhe në bashkëpunim me shoqatat qeveritare në Gjilan do të implemetohet dhe e ka fituar komuna. Aplikimet në të gjitha organizatat ndërkombëtare USAID-i, GIZI, TIKA, ERDISIA Zvicerane, të gjitha aplikacionet tona janë miratuar dhe asnjë përgjigje negative nuk e kemi deri më sot. Projektet e ujit do t' i bëjmë funksionale në çdo vend, sepse nuk mund të them se është kryer një projekt në Llashticë ose Cernicë, kurse ai nuk është funksional. Duhet miliona euro t' i derdhim në 13 fshatra në bashkëpunim me Qeverinë Zvicerane për ta realizuar funksionin e plotë të rrjetit të ujësjellësit në këto fshatra. Ne duhet të harxhojmë 10 milion euro

për t' i funksionalizuar rrjetet e ujësjellësve në disa fshatra, mirëpo kjo na pengon për ta shtrirë rrjetin e ujësjellësit në vendbanimet e tjera, por ne e kemi ruajtur parimin e kontinuitetit dhe projekteve të qytetarëve në interes të qytetarëve kudo që të jenë.

Sa i përket reagimeve ne ende nuk kemi reaguar, si p.sh, një kërkesë e LVV ka të bëjë me qiratë, kjo kërkesë është vendim i Komunës, por nuk ka bazë të fortë, por është vendim i KK-së dhe ne vendimin e kemi dërguar në MPL për ligjshmëri dhe në momentin që e kthehet dhe epet përgjigje pozitive ne fillojmë për t' i kryer obligimet ndaj partive që paguajnë qira.

Ishte çështje e kontratave në vepër, por nuk ka asnjë me përjashtim të asaj që i kemi publikuar zyrtarisht, por ka praktikantë të cilët po ndërrohen në çdo dy-tre muaj dhe për këtë arsyeje dikush mendon se të gjithë janë praktikantë. Drejtoria e Arsimit ka bërë marrëveshje me Universitetin e Gjilanit që të gjithë të diplomuarit të vijnë në shkollat e Gjilanit të bëjnë praktikë. Shkëputja e kontratës në vepër është shkëput me Kompaninë “Sas” kostoja e madhe dhe më mirë është që t' i paguajmë 10 punëtorë, se sa t' i japim 260 mijë euro në vit. Me ato para të kursyera ne i kemi kryer obligimet dhe nuk kemi pasur mundësi t' i dërgojmë askund parat. Mandje janë edhe dy kërkesa ndaj pensionistëve e që një qytetar e ka lëshuar objektin me qira dhe kjo çështje është në servisim të borxheve. Gjitha kursimet në kategori të shpenzimeve nuk kemi pasur mundësi t' i dërgojmë në rini, kulturë dhe sport, sepse shumicën i kemi shpenzuar për servisim të borxheve, sepse kemi vendos t' i kryejmë obligimet ndaj njerëzve pa marrë parasysh rrethanat që i kemi.

Unë jam i gatshëm që çdo iniciativë legjitime të votohet, por iu siguroj se për çdo sektorë dhe ndërmarrje komunale, kanë me ardh në raport para Kuvendit në mënyrë që Kuvendit të ketë informata.

Izmi Zeka- faleminderit kryetar, por nuk është me rëndësi se çka flitet, por me rëndësi është ajo çka shihet, sepse po shihet se çka ka ndryshuar, por i dimë edhe obligimet të gjitha. E dimë se 22 milion projekte ia kemi lënë të gatshme dhe 2 -3 milion janë vetëm në infrastrukturë rrugore e të cilat janë ofruar nga Ministria e Transportit, kurse tash ato jeni duke i realizuar. Përmendini edhe ato dhe mos i përmendini vetëm obligimet çdo ditë dhe gjërat e tjera vetëm negative.

Komuna gjithmonë do të mbes në obligime edhe ju kur ta lëni qeverisjen, por PDK-ja po kërkon diçka konkrete: lejet e ndërtimit, tregoni ku janë dhe sa janë? Pse po frikoheni prej kësaj kërkeje?

Mandej po e them pa inat, drejtori i Arsimit ende nuk ka dhënë informatë, mandej kryetari i Komunës duhet ta përmend se cila është arsyeja që drejtori i Inspeksionit është burgos 48 orë, duhet ta përmendni, sepse ky është organ vital i KK-së. Unë jam ithtar i asaj që të shoh se që një vit çka ka bërë Komuna? Mos të rrini në atë se çka është bërë që katër vite dhe çka ka bërë Qemajl Mustafa. Vazhdoni me rend të punës ne iu përkrahim, por asnjë kërkesë e jona të mos përkrahet, nuk aprovohet, nuk del në rend të ditës, çka kërkonit atëherë nga opozita? Unë e di se çka është opozita, por së paku të na krijoni mundësi të debatit. Ta themi edhe ne atë që e dimi, sepse e kemi një përvojë i kemi disa ekspertë dhe mund të themi se kjo është alternativë më e mirë.

Unë po kërkoj të na krijoni mundësinë për debat dhe t' ia imponojmë rendin e punës.

Te çështja e “KATANES” për shkak të ndjeshmërisë po e them se jam “për”, kurse për shkak të procedurave nuk do ta kisha kaluar. Duhet të mësohemi se ka rast edhe për ndonjë profet t' i zbatojmë procedurat. Për shkak të ndjeshmërisë, sepse kur është çështje e Dëshmorëve nuk jam ithtar për të mos votuar, por t' i përmbaheni procedurave dhe iu lus për herë të fundit.

Neve duhet të na epni hapësirë për të biseduar të lirë, çka iu pengon informata të mos epet? Ose informata në bujqësi. Ne jemi lodhë që katër muaj duke i kërkuar këto informata, kurse ju nuk po i jepni për të cilat ne nuk po e dimë as arsyen?

Valentinë Bunjkau- Rexhepi –kërkesat e juaja i dorëzoni me shkrim dhe nëse ndonjë iu ka mbetur për pa i dorëzuar i dorëzoni dhe do të merremi vesh me shefat e grupeve dhe do ta ftojmë një seancë të veçantë për këto informata.

Riad Rashtiti- unë po reagoj ndaj kryetarit të Komunës, sepse në një mënyrë po thotë se ne po shpifim., mirëpo ndërtimet pa leje nuk janë kërkesë e jona si opozitë dhe këshilltarë komunal, por është përgjigje e datës 24.10. 2014 të cilën e ka dërguar Valon Shefkiu i cili thotë objektet nuk janë të pajisura me leje nga ky organ dhe asnjëri prej tyre nuk ka parashutuar ndonjë kërkesë. Kjo është përgjigje zyrtare, nuk është e imja nuk është akuzë. Lista është kjo nëse ju si pozitë nuk i dini sa ndërtime janë pa leje ne i kemi dhe numri arrin në 55 objekte. Këto ndërtime pa leje i kanë kushtuar buxhetit të Komunës 160 mijë euro për pa i inkasuar.

Është fatura për blerje të veturës, nuk është, kjo nuk është shpifje, por është dokument i marrë nga institucioni i Komunës për qëllim të blerjes së kësaj veture. Mandej është një raport zyrtar i vulosur i protokolluar, nga Drejtorie Për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në të cili raport janë analizat e ujit të pijshëm dhe në bazë të këtij raporti prej 14 shkollave në 12 nuk pihet uji.

Lutfi Haziri- tendenca për t' i problematizuar disa nga çështjet problematike për motive të ngushta politike ose tjera duan ta dërgojnë Gjilanin në gracka që nuk ka qenë as pas luftës, as pas pavarësisë, as tash në një rrethanë krejt të re. E tha zv/ministri në detyrë se të gjithë anëtarët e KK-së kemi kaluar nëpër një rrugë të vështirë dhe në kohën kur nuk kemi pasur shumë përvoja kemi ditur për t' i sjell dhe gjendur. Mirëpo nuk dëshiroj të lejoj që insinuatat e tilla të bëhen perceptim. Nëse 14 shkolla nuk pihet ost uji, nuk është kjo në kohën prej 9 muajve dhe nuk ka mundur një kontaminim të bëhet për 9 muaj. Nëse një problem e qenve endacak ka qenë nuk kanë lindur këtë vit ose, ose për ndriçim publik 111 mijë euro i kam paguar si borxhe të vitit të kaluar, në kohën kur është bërë dritë me borxhe. Unë e kam thënë se ky vit është i vështirë, por kemi disiplinë buxhetore, ne duhet t' i kompensojmë ndriçimet e 2011 dhe 2012 për ta mbajtur Gjilanin në errësirë në vitin 2014. Kjo është e vërteta, sepse unë nuk mund të toleroj mos disiplinë buxhetore. Ne nuk mund të hyjmë edhe më thellë në borxhe ne duhet të dalim të zbardhim tabelorin, sepse edhe KE komunave për mos disiplinë buxhetore nuk iu jep grande dhe këtë e dini se nuk kanë dhënë. Përderisa ata nuk binden se kemi disiplinë buxhetore duhet harruar që mund të konkurrohet për ta marrë pushtetin.

Keni kërkuar disa lëndë për të cilat nuk jemi përgjigj, por kërkon për ta bërë publike po ta bëj!

Në 32 lëndë që kërkon letra nuk mund të përgjigjem, sepse janë subjekt i hetimeve nga Prokuroria Speciale e Kosovës. Zv/ ministri e dinë saktë se që në momentin që ka lëndë nën hetime ne nuk mundemi që dokumentet e tilla 32 lëndë ne të japim informata. Ju kërkon nga Prokuroria Speciale , ajo ia jep të gjitha lëndët. Të gjitha lëndët që z. Rashiti i kërkon janë subjekt i hetimeve dhe mendon se ne jemi model i njëjtë, por po iu them se asnjëherë nuk kam shkuar në Zyrë të Prokurimit, përveç tendencës për ta përmirësuar Zyrën e Prokurimit. Zyrtarët që janë problem dhe janë nën hetime do të ndërrohen nga vendi i punës përmes një konkursi të brendshëm.

Po iu them se nëse kryesuesja kërkon që të mbajmë seancë të veçantë për këto raporte, por është mirë që të na epni pak kohë për t' u përgatitur ose kurdo që jeni të gatshëm ne mund të bisedojmë.

Nuk pati debatues të tjerë për rendin e punës, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet rendi i punës, me propozimin e Këshillit të fshatit Zhegër.

Aprovohet rendi i punës me 23 vota të anëtarëve të Kuvendit, 2 abstenime, kurse të tjerët nuk u deklaruan për asnjë variant të votimit.

Procesverbali

Nevzad Isufi- së pari ne shfat e grupeve, ne jemi marrë vesh, por nuk kemi thënë se duhet të tejkalohen procedurat. Mandej në procesverbal është një konstatim, kur ne e kemi lëshuar seancën për shkak të vonësës së kryesuese ku thuhet:” opozita e ka lëshuar pa të drejtë seancën dhe nëse dikush kërkon të bëj skandale dhe cirk është çështje e tyre”.

Do të ishte mirë që të korrigjohet kjo dhe të mos i dezinformoni qytetarët, sepse kryesuesja është vonuar plotë 45 min. Unë mendoj se duhet të tërhiqe fjala e kryesuese dhe ta informojë drejtë

opinionin dhe shumë e sinqertë do të ishte që të kërkonte falje për këtë kualifikim. Skandale në nuk kemi bërë, por skandali dihet se i kujt ka qenë?

Mandej në shefat e grupeve kemi votuar për zbatim të procedurave dhe e kemi pasur fjalën që materiale sot të jetë në duar të anëtarëve të Kuvendit, materiali nuk është, prandaj kush është fajtor për këtë?

Serdan Mitriqi- unë po e shoh se ju e keni hedhur një pikë të rendit të punës për votim, për të cilën unë nuk e di se cila ka qenë përmbajtja dhe nuk e di cila ka qenë tema e votimit. Unë nuk e di as për çka ka folur kryetari, prandaj unë nuk jam këtu vetëm për t' i vërë dëgjuese në vesh, dhe të mos e di fare se çka thuhet! Ju keni votuar diçka për të cilën unë nuk e di. Po e reklamoj pabarazinë e pjesëmarrjes në KK dhe kjo po zgjat kohë të gjatë për të cilin fakt unë kohë të gjatë e kam potencuar. Kërkoj që të përmirësohet teknika e përkthimit, kurse për seanca herë lajmërohem herë jo, kurse materialin për këtë seancë e kam marrë në mbrëmje dhe nuk jam përgatitur për këtë seancë dhe nuk mund të votoj për pikat e rendit të punës!

Sadri Arfi – për një pjesë, Serdjani ka të drejtë, sepse në kemi kuadër të mangët të përkthimit, kurse në anën tjetër kemi shumë kërkesa të përkthimit. Mirëpo angazhimi jonë është së pari ta përkthejmë materialin e seancave të Kuvendit.

Sahit Abazi- e mbështesim diskutimin e LVV, sepse ju keni thënë se jeni vonuar vetëm 10 minuta dhe keni thënë se kemi shndërruar Kuvendin në cirk, prandaj kërkoj që t' i tërhiqni këto fjalë, sepse edhe zyrtarisht jeni vonuar 45 minuta.

Aprovohet procesverbali me këto vërejte

Valentinë Bunjaku Rexhepi- po kalojmë në pikën e parë të cilën e futëm në rend pune e cila është: Vendim për Memorialin “KATANA” në Zhegër dhe e ftoj z. Nevzad Rushitin, kryetari i Komitetit për Pronë të jep arsytimin.

Nevzad Rushiti- kjo kërkesë është nga Këshilli i fshatit Zhegër dhe një dhuruesi i cili është i afërt i Dëshmorit Agim Ramadani, të cilët kërkojnë një hapësirë publike për ndërtimin e këtij memoriali. Kërkesa është e mëhershme, por për shkak se dhurues udhëton jashtë Kosovës, kemi qenë të detyruar që ta të nxitojmë. Toka është pronë publike dhe jo pjellore.

Arijetë Rexhepi- unë jam anëtare e Komitetit për Pronë, desha të them se përkitazi me këtë vendim po e them me plotë kuptim se është e jashtëligjshme. Ky komitet është thirr, një ditë para seancës në ora 15 dhe nuk i ka as 24 orë që e kemi mbajtur mbledhjen. Sa është e ligjshme dhe sa janë zbatuar procedurat për këtë vendim po dihet edhe pse ne nuk kemi asgjë kundër këtij Memoriali.

Sahit Abazi- që të mos krijohet huti po e them se nuk ka shkelje ligjore, sepse ne po merremi vesh që ky Memorial të zbatohet në parim. Nuk do ta lavdëroj as bllokoj këtë çështje, sepse fjalët janë të tepërta, sepse jemi marrë vesh shefat e grupeve në parim për këtë Memorial. Ne vetëm e falënderojmë dhuruesin për një vepër të mirë e cila do të na shërbejë edhe për një dinjitet më të madh në Anamoravë.

Seami Xhemjali-unë vetëm po e rikonfirmoj atë që tha kolegu nga PDK, në materialin dje e kemi marrë, por për shkak të një Dëshmori dhe në respektim të Këshillit të fshatit edhe ne në parim e kemi përkrah dhe kemi dhënë mbështetje unanime.

Abdyl Aliu –është fat dhe është mirë që ka çështje të cilat na obligojnë për të menduar njëjtë !

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet kjo pikë e rendit të punës?

Aprovohet kërkesa e Këshillit të fshatit Zhegër: Vendim për Memorialin “KATANA” në Zhegër , me 32 vota të anëtarëve të Kuvendit

Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa

2.1. Vendimi për transferin dhe ridestinimin e mjeteve financiare

Ilmi Limani- këtë vendim e kemi marrë edhe në muajin korrik, por për shkak të mosfunksionimit të Kuvendit të Kosovës për rishikim nuk mund të zbatohet neni 30 Ligjit të menaxhimit të financave publike, neni 30.4 ku buxheti mund të ridestinohet pa kufij buxhetor. Për këtë arsyeje ministri mund të bëjë transfer vetëm deri në 15%. Ju keni marrë vendim për 100 mijë euro, por nuk mund Qeveria ta zbatojë atë shumë, por vetëm 59 mijë 700 euro, sa e lejon ligji. Ky është vetëm një korrigjim i atij vendimi të cilin e keni marrë ju.

Arijetë Rexhepi – unë do të ndërlihem për transferin dhe ridestinimin e mjeteve, por sa i përket ridestinimit të mjeteve nga drejtoritë përkatëse tek Zyra e Kryetarit për subvencione në vlerë prej 57 mijë e 906 euro, unë dhe grupi që përfaqësoj jemi kundër që të bëhet bartja e këtyre mjeteve. Këtë po e them se nga raporti financiar në mbledhjen e kaluar u pa se kryetari ka shpenzuar mjete edhe një herë më tepër se janë shpenzuar mjete edhe një herë më tepër se sa janë shpenzuar për mallra dhe shërbime. Vetëm Zyra e Kryetarit vetëm për 6 muaj i ka shpenzuar mbi 514 mijë euro, kurse për mallra dhe shërbime ka shpenzuar pak më tepër se 217 mijë euro.

Zijadin Maliqi- këto mjete (100) mijë euro, janë ndarë për ndërtimin e shtëpive të familjeve të skamnorëve dhe nuk janë për shpenzime të Zyrës së Kryetarit dhe as për mallra dhe shërbime. Mirëpo në pamundësi që të bëhet rishikimi i buxhetit, atëherë ministri për Ekonomi dhe Financa ka të drejtë deri në 15% ta bëjë ridestinimin. Ai ridestinim po arrin në 57 mijë euro, kurse pjesën tjetër do të bartet në vitin e ardhshëm.

Riad Rashti- fillimisht e kuptova se për çka bëhet fjalë për këtë vendim, sepse me shkrim nuk ka qenë i qartë, por nëse ka të bëjë me korrigjimin e vendimit i cili është nxjerr në qershor për lejimin e 100 mijë eurove, unë mendoj se ky vendim së pari ka qenë desh të anulohet, sepse ky është vendim që e ka marrë KK. Para se ta marrim këtë vendim ka qenë desh ta anulojmë vendimin e kaluar për ta marrë këtë vendim. Kërkoj sqarim nga Zyra Ligjore a duhet vepruar kështu apo jo!

Po ashtu unë e kam edhe një shqetësim që ka të bëjë me shumën e shpenzimeve 328 mijë euro për subvencione e cila është një shumë e madhe dhe thuhet se janë shfrytëzuar për përfitues individual në vlerë 157 mijë €. Ky për neve është një shpenzim jo transparent, sepse unë i kam kërkuar në Drejtorinë për Financa për ta ditur ku janë shpenzuar këto subvencione, por nuk më është dhënë lista e shpenzimeve të tilla. Unë nuk kam kërkuar asgjë të paligjshme, por Komuna është jo transparente dhe nuk kemi qasje në dokumente.

Tjetra është se këto mjete që po destinohen askush nuk e dinë se për cilat familje janë destinuar ?

Kërkoj nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe nga të tjerët nëse kanë përgjigje për ta ditur a ka komision komunal të formuar për këtë çështje apo nuk ka?

Po ashtu në seancën tjetër kërkoj informatat për dhuruesit të cilët janë deklaruar për ta mbështetur aksionin për grumbullim të mjeteve për familjet skamnore.

Gjithashtu të ofrohet lista e familjeve të cilave iu është planifikuar që t’i mundësohet strehimi i tyre?

Lutfi Haziri- sa i përket fondit të Komunës prej 100 mijë €, për familje të skamnorëve ka të bëjë me kontinuitet dhe Komisioni komunal merret me trajtimin e rasteve. Lista është ajo që është gjet, familjet janë të njëjta, por edhe angazhimi është i njëjtë. Kjo kryesisht ka të bëjë me banimin social. Ne e kemi gjetur një dokument dhe një angazhim të qeverisjes së kalbur e cila është marrë me vendosje të familjeve me banim social, por të gjitha ato familje janë larguar për shkak të kostos. Një familje e cila nuk ka mundësi për ta paguar banimin është e pamundshme për ta paguar ujin rrymën dhe në këtë mënyrë kanë shkaktuar edhe probleme të tjera. Jam shumë i kënaqur që solidariteti i njerëzve e ka rrit fondin tonë prej 100 mijë eurove, por edhe se cili prej juve mund ende të kontribuojë. Të gjitha rastet do të trajtohen përmes një komisioni i cili do të merret me implementim dhe një organi mbikëqyrës nga ana e Komunës. Do t' i propozojmë KK-së për ta zgjedhur një organ i cili do ta mbikëqyrë zbatimin e këtij fondi. Ne jemi të interesuar që të gjejmë raste çdo vit deri në zhdukje të problemit të banimit social. Sivjet anë paraparë të harxhohen 52 mijë euro, kurse pjesa tjetër do të mbetet në vitin vijues.

Hevzi Matoshi- vendimi paraprak që është marrë nga KK, ka qenë një vendi i drejtë, por për shkak që Kuvendi i Kosovës nuk po ka mundësi të funksionojë ato mjete që janë paraparë për të harxhuar këtë vit ministri e merr vendim që të destinohen vetëm 15% e atyre mjeteve. Ai vendim nuk ka prodhuar asnjë efekt juridik, por mund edhe të anulohet.

Riad Rashiti-për mua është palogjikshme të thuhet se nuk ka efekt një vendim që e ka marrë KK. Nëse ne marrim vendime pa efekt, nuk e di pse po e marrim këtë vendim. Ai vendim i cili është marrë me 26 qershor ai duhet të anulohet, sepse është në fuqi, është protokolluar dhe ekziston sot në zyrat e KK-së. Ai vendim duhet të anulohet dhe të aprovohet ky vendimi i sotëm dhe këtu nuk ka asgjë të keqe.

Hevzi Matoshi- në momentin kur është marrë vendimi, ai vendim ka qenë shumë i drejtë dhe është menduar për një situatë që duhet rregulluar në MEF. Nga dita që Kuvendi i Kosovës nuk mund të veprojë i njëjti vendim nuk prodhon më asnjë efekt juridik. Unë kështu e thash dhe më duket është shumë e qartë.

Zijadin Maliqi- edhe herën e parë edhe tash që po marrim këtë vendim po i propozojmë Kuvendit të Kosovës, gjegjësisht ministrit të MEF-it. Në vendimin e parë ne kemi propozuar që ato mjete të ridestrinohen për qëllim tjetër, vendimin si vendim me rishikim ka desh ta merr Kuvendi i Kosovës. Mirëpo gjendja në Kuvend të Kosovës po dihet si është, kurse tash është vendim i ministrit, por ministri nuk ka të drejtë ta bejë ridestininimin më shumë se 15% të atyre mjeteve.

Lutfi Haziri- sipas Ligjit të buxhetit Qeveria ka kërkuar nga ne rishikimin e buxhetit në periudhën kohore të caktuar i cili ka qenë desh të lejohet në radhë të parë në kabinet, pastaj të shkojë në Kuvend për miratim, por pasi ky cikël nuk është mbyll, atëherë askush nuk ka autoritet për ta bërë një rishikim. Këtë e rregullon neni 30.1. dhe 30.2

Riad Rishiti- unë përsëri po kërkoj përgjigje, sepse Zyrtari Ligjor po jep përgjigje politike dhe pyetje është konkrete a duhet të anulohet vendimi i mëparshëm apo jo?

Hevzi Matoshi – unë isha shumë i qartë, por ndoshta nuk po kuptohemi në aspektin e terminologjisë juridike. Kuvendi në këtë rast nuk ka nevojë ta anulojë këtë vendim! Është e qartë se ai vendim nuk ka prodhuar asnjë efekt dhe kur nuk prodhon asnjë efekt nuk ka nevojë të anulohet.

Nuk pati debatues të tjerë përkitazi me këtë pikë të rendit të punës, kurse kryesuesja kërkon nga anëtarët e Kuvendit që të aprovohet kjo pikë e rendit të punës.

Aprovohet pika 2.1- Vendimi për transferin dhe ridestinimin, me 34 vota të anëtarëve të Kuvendit.

Pas kësaj pike të rendit të punës, kryesuesja i liron anëtarët e KK-së 10 minuta në pushim.

2.2.- Raporti financiar janar –shtator 2014

Pas pushimit prej dhjetë minutave, kryesuesja kërkoi që të verifikohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit në vazhdim të punimeve të seancës, kurse sekretari konstatoi se të gjithë anëtarët ishin prezent.

Ilmi limani- Limani- para se të filloj për të dhënë sqarime për raportin financiar, unë e kam një njoftim për juve të cilin besoj se në Kuvend do ta përkrahni. Në muajin korrik e kemi nxjerr një vendim për rishikim të buxhetit, mirëpo për shkak të mos konstituimit të Kuvendit të Kosovës, buxheti me rishikim nuk ka kaluar, prandaj duhet bërë një korrigjim, sepse me rishikim 100% mund të bëhen transferet dhe ridestinimet, sipas nenin 30.4 të Ligjit të menaxhimit të financave publike.

Mirëpo pasi Kuvendi i Kosovës nuk po konstituohet, duhet ta zbatojmë nenin 30.2 ku vetëm 15% mund t' i bëjmë ridestinimet dhe transferet. Do të thotë vetëm një korrigjim i shumave më të vogla dhe këtu është fjala për ndarjen e subvencioneve për familjet skamnore. Ne kemi marrë vendim për 100 mijë €, por me këtë 15% nuk arrin shumë mbi 57 mijë €. MEF- ka kërkuar që t' i njoftoj se nuk mund të realizohet shuma prej 100 mijë €, por mbi 57 mijë € në këtë vit. Ne nuk duhet të veprojmë sipas nenin 30.2, por po të ishte konstituuar Kuvendi i Kosovës ishte zbatuar nenin 30.4 ashtu si e kemi aprovuar në Kuvend. Ju lutem që ta përkrahin këtë ndryshim

Sa i përket shpenzimeve të mallrat dhe shërbimet nëse shkoni deri në fund shihet se vitin e kaluar janë paguar në të njëjtën periudhë 2 milion e 314 mijë e 966 euro, kurse këtë vit janë paguar 2 milion e 115 mijë, por nga kjo shumë janë paguar borxhe të trashëguara mbi 884 mijë €. Është një punë e mirë se borxhin që e ka pasur Komuna e Gjilanit ka një rënie shumë të mirë. Në fund mujor e shihni se borxhe janë paguar 1 milion e 985 mijë 400 €. borxhe të trashëguara nga viti paraprak).

Këtu i keni në analitikë për çdo shpenzim dhe do të mundohemi t' i japim përgjigje në pyetjet e juaja.

Zijadin Maliqi- Raporti financiar i raporton të gjitha të hyrat dhe shpenzimet gjatë një periudhe të caktuar. Ky raport është i përgatitur në mënyrën më të mirë dhe në mënyrë standarde si në mënyrë analitike dhe sintetike. Gjatë analizave që ia kam bërë këtij raporti kemi një realizim për afër 3% më të mëdha se 9 muhori i vitit paraprak dhe i kemi diku afër 70% të realizimit të planit të buxhetit i cili është planifikuar për vitin 2014. Pritshmëria ka qenë më e madhe, por edhe kjo gjendje nuk është keqe. Nëse i shikojmë të hyrat nëpër disa drejtori e kemi një realizim shumë të mirë të hyrave , por në disa kemi edhe ngecje në këtë drejtim si te biznesi, qiraja, inspeksioni etj.

Kemi të hyra më të mëdha të gjobat në trafik, por për këto të hyra ka shkrime se gjëja Komuna po i gjobit, qytetarët e vetë, por ajo nuk qëndron, sepse gjobat në trafik caktohen nga niveli qendror.

Kjo rritje është bërë se gjatë kundërvajtjeve në trafik, udhëtarëve ia konfiskon ndonjë dokument dhe qytetarët në këtë formë janë të obliguar patjetër t' i paguajnë gjobat.

Sa i përket shpenzimeve të gjitha janë afër 75% dhe është shumë në rregull me atë që është planifikuar. Te mallrat dhe shërbimet i kemi diku 70% të kodeve buxhetore dhe shpenzimet për këtë vit janë më të vogla, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Nga kjo shihet se janë bërë kursime dhe nga këto kursime kemi paguar borxhe mbi 845 mijë €. Në të gjitha kodet kemi kursime dhe kjo na ka mundësuar që të kryejmë obligime (borxhe) në vlerë prej 2 milion €.

Riad Rashiti- unë në emër të grupit të PDK-së do t' i jap vlerësimet për këtë raport 9 muhori të cilin raport e kemi analizuar edhe pse kemi mungesë të dokumentacioneve, për disa shpenzime. Ne si opozitë e shohim si jo efikasitet të drejtorive komunale për ta realizuar planifikimin 9 muhori.

Drejtori e tha se ka rritje të hyrave 3% , mirëpo në shikim të parë mund të pranohet kjo, por nëse ndalemi dhe analizojmë më detajisht e shohim se nuk qëndron kjo, sepse nëse e bëjmë krahasimin me vitet paraprake, por nëse i analizojmë të hyrat paraprake që ka qenë e planifikuar 3 milion e 700 mijë €, shihet se në shumicën e drejtorive ka rënie dhe ka ngecje. Në total janë 477 mijë € të hyra më pak nga planifikimi vjetor i drejtorive e të cilat do t' i përmendi.

Në Administratën e Përgjithshme mbi 10 mijë € janë më pak të hyra, të hyrat nga qiraja janë vetëm 32% të realizuara, te të hyrat nga biznesi kemi rënie për 74 mijë €, të hyra nga ndërtimi kemi rënie për 160 mijë €, të hyra nga shërbimet publike kemi më pak mbi 2600 €, nga Inspeksioni i kemi mbi 16 mijë€ më pak , nga Drejtoria e Bujqësisë kemi 11 mijë e 700 € më pak, te Arsimi kemi mbi 32 mijë euro më pak të hyra dhe te shëndetësia janë më pak mbi 30 mijë €, kurse të hyrat nga koncesioni janë zero €. Në total është shuma prej 477 mijë € që janë të hyra më pak.

Ne dimë se Komuna nuk bënë gjoba në trafik, por në saje të këtyre gjobave ju po arsyetoni mos punën dhe mos efikasitetin e juaj. Ky kod i gjobave e ka barazuar dhe e ka tejkaluar totalin e të hyrave, sepse vetëm nga gjobat në trafik janë grumbulluar gjysmë milion €.

Sa i përket investimeve ne dhe këtë kriter e kemi analizuar dhe shihet se në këtë drejtim kemi rënie të investimeve në krahasim me vitin e kaluar mbi 2 milion euro më pak investime kapitale. Gjatë këtij viti janë shfrytëzuar 2.6 milion €, kurse vitin e kaluar janë shfrytëzuar 4.8 milion €.

Nëse i marrim parasysh edhe të dhënat nga sektori privat, shihet se kemi në rënie të investimeve me PPP-në i cili totalisht është i bllokuar në Gjilan. Në bashkëpunim me PPP-në ne vitin e kaluar kemi investuar 4 milion investime, por këtë vit jo që është bërë diçka në këtë drejtim, por i ka penguar edhe projektet e filluara nga qeverisja e kaluar. Është stopuar i tërë projekti i PPP-së në vlerë prej 1 milion €. Te Tregu i Gjellbër nuk kanë filluar investime fare edhe pse është paraparë 1.5 milion investime. Te transporti publik dihet se është bërë aprovimi vitin e kaluar dhe ai projekt ka qenë desh të fillojë këtë vit, sepse kanë përfunduar të gjitha procedurat. Po ashtu te salla e Sporteve ne e kemi paraparë një qendër rekreative në vlerë prej 1 milion €, gjithashtu ka qenë projekti i Zonës Ekonomike Rajonale në vlerë prej 1 milion €. Të gjitha projektet madhore shihet se Komuna i ka bllokuar dhe 5 milion €, kanë mbetur në vend dhe asnjë lëvizje nuk është bërë.

Te shpenzimet ka në disa kode rënie të shpenzimeve, mirëpo në total është e njëjta gjendje e cila ka qenë edhe vitin e kaluar. Te kodet e tjera në total e kemi konstatuar se këtë vit janë shpenzuar 15 milion e 308 mijë €. Edhe më 2013 ka qenë kjo gjendje është një ndryshim shumë i vogël ose thuaja se fare nuk ka ndryshuar.

Te shpronësimet ka qenë e planifikuar të shpenzohen 600 mijë €, kurse janë shpenzuar 284 mijë €, do të thotë mbi 50% e fondit nuk është shpenzuar. Ky dallim në mes planifikimit dhe shpenzimet kërkon një përgjigje pse nuk janë shpenzuar mjetet? Në Bujqësi kanë qenë të planifikuara për projekte zhvillimore 80 mijë €, por janë shpenzuar afër 25 mijë €.

Për salla dhe terrene sportive kanë qenë të planifikuara 270 mijë €, kurse janë shpenzuar vetëm 33 mijë €. Sa i përket bartjes nga viti i kaluar, kemi pasur një bartje në vlerë prej 337 mijë €, e të cilat kanë qenë të hyra nuk kanë qenë, por prej tyre janë shpenzuar vetëm 267 mijë €.

Është e vërtetë se në disa kode ka zvogëlim të shpenzimeve, por kjo nuk është bërë nga kursimet, por është bërë për shkak të faturimit të vonuar dhe pagesave të vonuara.

Është e vërtetë se disa shpenzime janë zvogëluar, por nuk mund të thuhet se ka zero shpenzime dhe gjatë këtij 9 mujori shihet janë shpenzuar 88 mijë për dreka zyrtare. Mirëpo ka edhe tjera shpenzime të tilla, por po i mbuloni në mënyra të tjera. Po ashtu thoni se ka zero shpenzime për mbushje të telefonit, mirëpo për mbushje dhe telefoni janë shpenzuar mbi 29 mijë €.

Nga shihet se nuk ka shpenzime zero të cilin fakt ne e kemi ditë, sepse nuk mund komuna të funksionojë me zero shpenzime. Gjithashtu kemi shpenzime të udhëtimit jashtë vendit e të cila vizita më tepër janë bërë për vizita private se sa për ndonjë vizitë studimore, apo të ndonjë qëllim që ka të bëjë me nxitje të investimeve etj. Në vijim të fjalës së tij z. Rashti i përmendi edhe disa shpenzime të tjera të cilat janë bërë gjatë kësaj qeverisje.

Avdyl Aliu- kur kemi thënë se dieta buxhetore do të na bëjë dobi të gjithëve këtu, prandaj unë do të ndalem te disa kode ekonomike duke bërë krahasime në mes vitit 2013 dhe atij 2014.

Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit është një dallim prej 48%

Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit është dallimi 500% ka ulje të shpenzimeve, për të cilin kod theksohen edhe shuma.

Mëditjet e udhëtimit jashtë vendit ka ulje 215%

Shpenzimet e tjera për telefoni “Vala” 315%

Shërbime të ndryshme shëndetësore 3100% është ulja e shpenzimeve.

Shërbime shtypi jo marketing është 38%.

Shërbimet kontraktuese të tjera 205%

Karburant për vetura 70%, regjistrim të automjeteve 51%

Mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve 260%

Mirëmbajtja e ndërtesave 45%

Shpenzimet për informim publik 1260%, telefoni PTK 20%

Drekat zyrtare 965%

Unë i përmenda vetëm disa kode, por në çdo shpenzim dhe kod vërehen zvogëlime të shpenzimeve, dhe të gjitha këto e kanë bërë një diferencë prej 2 milion €. Me këto 2 milion €, ne kemi paguar borxhe dhe e inkuarojmë qeverinë që të punojë në këtë drejtim. Në këtë mënyrë edhe ia kthejmë dinjitetin Komunës në raport me operatorët ekonomik.

Lutfi Haziri-për hir të korrektësisë unë po i arsyetoj disa nga kërkesat të cilat u paraqiten gjatë debatit. Ajo çka tregon pasqyra e nëntë mujorit është ajo që ne nuk e kemi pritur dhe e kemi menduar se do të jetë më e mirë, sepse kemi aplikuar një qeverisje të butë dhe karshi kategorive prej të cilave ne grumbullojmë të hyra komunale. E kemi respektuar një vendim të ish administratës ku është lejuar të grumbullohet taksa 50% e shumës nëse paguhet.

Kemi edhe kategori që iu janë dhënë të tjerëve sipas rregullores së tarifave për t’ i ulur për ta rrit sigurimin, por ajo që ne si vlerësim gjeneral që e kemi parë është që impakti i zgjedhjeve parlamentare dhe mos krijimi i institucioneve të vendit ka bërë shumë një kategori e madhe e njerëzve, sidomos të hyrave të pritura nuk i kanë realizuar. Kategoritë e caktuara presin reforma fiskale të cilat i ka Qeveria në dorë dhe bie motivi, bie arsyeja për t’ i paguar këto shpenzime.

Taks forca e krijuar për borxhe deri më tash është marrë vetëm me servisimin e borxheve dhe obligimeve për t’ u liruar nga problemet. Tash e tutje nëse është bërë pasqyra e borxheve ndaj Komunës do të fillojë të përfshihen edhe autoritet e reja si gjyqësori, përmbaruesi për të filluar të grumbullon një numër më i madh i mjeteve të cilat janë duke qëndruar në ekonomitë familjare, posaçërisht te biznesi. Nën dy unë zotohem edhe njëherë para juve që Komuna e Gjilanit nuk do të bëjë biznes as nuk do të blejë dhe as nuk do të shes asete komunale. Për derisa unë jam i zgjedhur i këtij qyteti iu lus që ta shfrytëzoni këtë të drejtë, sepse dallimi me administratën e kaluar është që tendenca përmes programit të PPP-së dhe koncesioneve të ndryshme të krijohet biznes në të hyra komunale, ka dëmtuar asetet komunale sipas mendimit tonë.

Natyrish që ne kemi krijuar ambient për zhvillim ekonomik, për koncesion në interes të Komunës dhe mundësi të tjera për PPP, por jo për të shitur dhe blerë. Në këtë mënyrë banesat që janë me interes e që po përmenden këtu si para ne nuk e kemi ndërmend për t’ i grumbulluar, por ne e kemi në plan ato banesa, numrin më të madh të tyre t’ i japim kategorive që nuk kanë shtëpi !

Të ia japim njerëzve që nuk kanë banim. Pse duhet të dalim t’ i lusim njerëzit për të kontribuar në zgjidhjen e problemit social, kurse ne kemi banesa të cilat duhet të epen për banim social. Në këtë mënyrë ne mund ta zgjedhim problemin e shumë familjeve të cilat bëhen me kulm mbi kokë në kohën kur kanë nevojë të kenë banim. Ky është angazhim të cilin e kam thënë që në fillim dhe e kam thënë në një seancë të mëparshme.

Nën dy çka do të kishte ndodh t’ i kishim 500 mijë € më shumë dhe çka mos t’ i kishim pasur 2 milion borxh? Përgjigja është se i kishim pasur 2.5 milion më shumë ! Në këtë mënyrë kishim

zgjidhur shumë probleme, por realiteti është ky! Ne kemi vendos që në tre mujorin e parë që obligimet ndaj operatorëve në Gjilan dhe ndaj disa familjeve që ka obligim për shpronësime, në

Gjilan ka pasur shifër prej 1.9 milion €, e cila është sasi e madhe. Mirëpo më mirë është sot të fillojmë t' i servisojmë se t' i shtyjme borxhet dhe të merremi me improvizim dhe të merremi me këto mjete dhe të krijojmë efekte të një viti. Ne e kemi marrë rrugën më të rrezikshme, sepse janë obligim 300 mijë €, ndaj operatorëve të shpronësuarve dhe do të vazhdojmë me këtë logjikë të punojmë, derisa t' i largojmë të gjitha obligimet. Dua ta përmendi një fakt se Administrata ime ka paguar fatura të ushqimit dhe kjo ka ndodhur, sepse është në pasqyrën e borxheve dhe është një shumë e konsiderueshme e mjeteve. Ne kemi paguar edhe borxhe të biletave dhe reklamave, sepse kemi vendos për ta servisuar një kategori. Sidoqoftë te shpronësimet janë 1.2 milion €, është lajm i mirë që e kemi arrit. Afër 1 milion €, buxhetit të bujqësisë, 2.2 milion € për përmirësim të infrastrukturës e që është lajm i mirë për Gjilanin. Kategoria e arsimit për Gjilanin, problemet e transportit dhe disa borxhe ndaj arsimtarëve kemi arrit t' i pasqyrojmë në buxhet. Javën e fundit me këtë Qeveri në detyrë ne kemi arrit për ta përmirësuar buxhetin jashtëzakonisht shumë. Tri pikat kritike që i kemi pasur ne kemi arritur t' i përmirësojmë dhe shpresojmë shumë pasi të konstituohet qeveria e re gjendja do të përmirësohet edhe më shumë.

Riad Rashiti- kryetari u ndal te investime dhe i quajti diskriminim, anashkalim etj. Nëse flasim me vëmendje unë po flas me shifra zyrtare. Shifrat zyrtare flasin se në 2007 kur ne e kemi marrë pushtetin në Gjilan buxheti i përgjithshëm ka qenë mbi 9 milion e 600 mijë €, kurse sot është afër 21 milion. Kemi të hyra për 10 milion të buxhetit komunal. Mirëpo për sa u diskriminuar Gjilani prej qeverisë aktuale po i jap disa shifra përsëri. Në vitin 2007 Gjilanit i kanë ardhë investime mbi 276 mijë € (grande). Në 2013 kanë ardhur mbi 3 milion e 800 mijë, grande të Qeverisë. Kemi një rritje prej 2500%. Po ashtu kanë ardhur edhe 2.5 milion me rishikim të buxhetit. Gjilanit në 2013 i kanë ardhur 6 milion investime, kurse në 2007 i kemi pasur 276 mijë €. Z. kryetari ka qenë zv/kryeministër dhe Gjilanit nuk ia ka sjell asnjë projekt. Pse ju nuk e keni shfrytëzuar autoritetin e juaj për t' i sjell Gjilanit investime? Për këtë arsyeje nuk duhet të bëjmë politikë, por të flasim me shifra. Sa i përket banesave ka qenë projekt i KK. Sa i përket shpenzimeve ka zvogëlim, por kjo nuk është si pasojë e kursimit, por është si pasojë e mos faturimit.

Nevzad Isufi- unë po ndalem vetëm te një shifër që thuhet se Komuna ka borxhe dhe të gjithë jemi pajtuar me këtë fakt dhe nga drejtori u dha shifra ekzakte edhe me qindarka. Për hir të transparencës do të ishte mirë që të emërojmë këta borxhli. Duhet të njoftohemi se kujt i kemi borxh? Kujt ia kemi paguar afër 2 miliard €, ? Ne pajtohemi se është mirë kjo dhe nëse shkohet me këtë trend, mirëpo në një seancë duhet të thuhet me emër dhe mbiemër se kujt i ka borxh komuna, por edhe kush i ka borxh Komunës. Ne duhet t' i dimë edhe njerëzit të cilët na kanë pritur dhe t' i falënderojmë ata njerëz që i kemi borxh. Të jemi më transparent, kujt i kemi borxh, kujt ia kemi shlyer borxhin dhe kush është në radhë për t' ia shlyer borxhin. dhe kështu me radhë?

Lutfi Haziri- nuk do ta zgjas shumë, por ta krahasosh vitin 2013 me 2007 është e pakuptimit dhe është fyerje e qytetarëve. Pse është fyerje? Më 2007 Kosova nuk ka pasur status final dhe e ka pasur buxhetin 600 milion €, kurse tash i ka 1.5 miliard. Gjithashtu më 2007 Kosova nuk ka pasur autostrada, nuk ka pasur ide ëndrra dhe projekte dhe shumëçka tjetër. Duhet bërë krahasim me 2013 dhe 2014, por mund të krahasohet Gjilani me Prizrenin ose me Ferizajn. Janë komuna të përafërta me numër të banorëve me infrastrukturë etj. Mirëpo ajo ka kaluar dhe nuk kemi se çka të kthehemi prapa. Kam qenë zv/kryeministër tri vjet, mandej kam qenë ministër 38 muaj dhe kam qenë ministër prej 2008 deri më 2010. Nuk ka e kam atë problem të detyrave që i kam ushtruar, kam qenë ministër edhe i z. Thaçi dhe gjithmonë kam qenë i zgjedhur dhe jo i deleguar. Kjo është dallim i madh dhe substancial, por ajo që desha ta them atë që e tha z. Isufi se çdo qindarkë e paguar në

këta dy milion që pasqyrohen si borxhe do ta keni, sepse listën në kemi sipas gjendjes që ka qenë në drejtori. Ka pasur disa prioritete të disa operator sidomos në tre mujorin e parë e të cilët kanë qenë në gjendje të rëndë, por edhe kanë bërë presion të madh për t'iu paguar obligimet për shkak të gjendjes ekonomike. Afër 20 projekte në Gjilan që përfshin edhe Kodrën e Dëshmorëve në Gjilan, njollën më të madhe sot e deri të ndërtesa e Ministrisë së Punëve të Brendshme janë të pa realizuara që janë projekte të vitit 2009 deri më tash. Janë miliona euro për 19 programe.

Në disa projekte kemi pengesa ligjore dhe nuk mund t'iu vazhdojmë, kurse disa nga projektet nuk janë tonat dhe nuk i takojnë Komunës së Gjilanit. Projekti i KE nuk është problem i Komunës, ndërtesa e Ministrisë së Punëve të Brendshme nuk është problem i yni. Mirëpo të gjitha programet tjera që janë 16 janë projekte të Komunës. Kjo ka ndodhur se projektet kanë filluar pa zotim të mjeteve. Këto projekte janë problem në vete, por që duhet t'iu diskutojmë në një seancë tjetër.

Arben Maliqi- është e vërtetë se disa gjëra nuk varet prej neve. Unë raportin financiar janar-shtator e pranoj ashtu siç është, mirëpo nuk duhet harruar se jo vetëm Gjilani, por secila komunë e Kosovës ka probleme të mëdha. Mirëpo dëshirojmë që të zgjidhet ngërçi politikë që njëherë e përgjithmonë ta formojmë një qeveri të mirë dhe që Anamorava ta ketë një lidhshmëri të vetin i cili do t'iu mbrojë interesat tona dhe të mendojë për të mirën tonë. Kemi shumë borxhe, ka shpronësime, kemi për të ndërtuar infrastrukturë sportive dhe shkollore, por këto nuk mund t'iu realizojmë vetëm me mjete të Komunës, por na duhen grande edhe nga Qeveria.

Unë iu lus të gjithëve se borxhin duhet shlyer, sepse borxhi dhe belaja nuk pret ditë të mira. Borxhet sidomos duhet të shlyhet për shpronësime dhe dëshirojmë që zoti të jetë me neve dhe dëshirojmë që të kthehet edhe nga Anamorava. Gjilani nuk guxon të mbetet zorrë qorre.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet 2.2

Aprovohet pika 2.2: Raporti financiar janar –shtator 2014, me 28 vota të anëtarëve, kurse të tjerët nuk u deklaruan për asnjë variantë të votimit.

2.3- Statuti për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Gjilanit 01- nr.53125 të datës 11.11.2011.

Valentinë Bunjaku –Rexhepi- ne për këtë çështje e kemi formuar një komision i cili ka punuar për ndryshim dhe plotësim të statutit, prandaj fjalën do ta ketë kryetari i komisionit Arben Mehmeti.

Arben Mehmeti- Komisioni për akte normative e ka diskutuar çështje e modifikimit të Statutit të Komunës duke u bazuar në faktet e reja si në ndryshimin e numrit të popullsisë ose me ndryshme të ligjeve të tjera që rregullojnë fushat e ndryshme. Në pika të trasha disa çështje që prekin organizimin komunal dhe ne si komision profesional ne e kemi ofruar para KK-së një propozim tonin si komision dhe iu ftojmë që këtë propozim tonin ta aprovoni. Meqenëse e kemi mandatin e KK-së ne jemi munduar që në pika kryesore ta mbajmë autoritetin tonë si KK, duke i planifikuar disa komitete me qëllim që ta forcojmë rolin e KK-së. Ta bëjmë më funksional dhe përmes këtyre trupave të Kuvendit t'iu mbajmë në kontroll dhe monitorim dhe shërbimin civil të Komunës së Gjilanit. Në funksion të kësaj ne kemi propozuar edhe rritje të numrit të komiteteve, por esenca është që të rritet roli i këtij Kuvendi i cili është organi më i lartë i Komunës së Gjilanit.

Sa i përket drejtorive mendoj se është më tepër përgjegjësi e kryetarit të Komunës se si funksionon shërbimi civil, drejtoritë përkatëse. Mirëpo kryetari vetë i ka përcaktuar se sa drejtori duhet të jenë në Komunë, sepse është i zgjedhur nga qytetarët dhe ka obligim për ta udhëhequr shërbimin civil.

Ne si komision të Drejtorisë së Shërbimeve Publike ai kemi shtuar edhe një kompetencë dhe ajo është banimi. Tash e tutje nëse aprovohet do të quhet Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Banimit. Ne këtë e kemi bërë, sepse ne si Komision kemi ardhur në përfundim se banimi më së tepërmi lidhet me këtë drejtori.

Te komitete më parë ka qenë për Kulturë dhe Sport dhe Çështje Gjinore, por pasi që e kemi edhe komitetin për Çështje Gjinore, tash e kemi të ndarë Komitetin për Rini, Kulturë dhe Sport, kurse atë për Çështje Gjinore është komitet i veçantë.

Gjithashtu i kemi edhe zyrat e reja dhe një ndër to është edhe Zyra për Presheve, Medvegje dhe Bujanoc i cili komitet është propozuar për herë të parë.

Këto janë propozimet tona e të cilat ju i keni analizuar, kurse për çdo pyetje komisioni është këtu dhe ju mund të jepni vërejtje dhe propozime.

Shpresë Kurteshi-është një falënderim i Komisionit për ndryshime statutare i cili me shumë arsyeje i cili ka konsideruar se është e nevojshme të merret parasysh edhe mendimi i kryesuesve të disa komiteteve dhe drejtorive që të parashihen disa ndryshime. Unë i jap mbështetje të plotë themelimit të Komitetit për Barazi Gjinore dhe shkëputjen e këtij komiteti nga ai për Kulturë, Rini dhe Sport.

Arben Maliqi- edhe unë e përshëndes grupin i cili ka punuar në plotësim dhe ndryshim të Statutit të Komunës, mirëpo unë i kam disa vërejtje dhe këshilla të mia edhe si ekspertë për komunitetin e sportistëve. Së pari te neni 34 më vjen mirë dhe tash do ta kuptojnë të gjithë anëtarët e Kuvendit se nuk janë këshilltarë, por janë anëtarë të Kuvendit. Mirëpo brenga ime më e madhe është, por unë e vlerësoj punën e kryetarit të Komunës dhe Komisionit, sepse ata kanë punuar, por kryetari më tepër ka menduar për zvogëlim të disa drejtorive si është ajo e Inspeksionit dhe Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Unë po fokusohem më tepër te kultura dhe sporti, sepse kohëve të fundit, sporti kosovar po merr masa ndërkombëtare dhe lajm i mirë është se sporti është përfshirë edhe në Komitetin Olimpik edhe në të gjitha federatat tjera sportive, por pranohen në përmasa evropiane.

Mirëpo unë e lus kryetarin e Komunës që në asnjë mënyrë të mos zbehet kjo drejtori, sepse tash është shndërruar në njësi, por ta luaj rolin e vetë, sepse dihet se identiteti i një populli afirmohet përmes sportistëve e të cilët janë ambasadorët tanë. Unë bëj apel që sportin të mos e harrojmë dhe lëmë anash dhe si të tillë jam për ta votuar.

Sahit Abazi- unë e përshëndes ekipin e cila ka punuar në këto plotësime dhe ndryshime të statutit e cila ekip mendoj se ka punuar seriozisht, por edhe ndryshimet më duket se janë për të mirë, si është themelimi i komiteteve etj. Mirëpo kemi një problem serioz te shuarja e drejtorive që nuk jemi bindur se me shuarjen e Drejtorisë së Inspeksionit dhe të asaj për Kulturë, Rini dhe Sport do të arrihen efekte më serioze. Ndoshta ka qenë faji i një debati i cili nuk është mbajtur për këtë çështje, një debati më serioz publik. E lus kryetarin që sot të na bind për këto efekte. Mirëpo në anën tjetër e kemi një rast edhe më drastik, shuarjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për të cilën nuk kemi pasur rast për ta ditur se cilat janë efektet pas shuarjes? Unë mendoj se Kultura, Rinia dhe Sporti në këtë mënyrë do të mbetën pa adresë. Ne mendojmë se do të duhej të ndodhte e kundërta dhe këto dy drejtori përmes statutit do të fuqizoheshin edhe më tepër. Sikur të fuqizoje Drejtoria e Inspeksionit dhe në atë Drejtori do emërohej një njeri i përgjegjshëm, sigurisht se sot nuk do t' i kishim 54 ndërtime pa leje në qendër të qytetit. Ne nuk jemi të bindur se shuarja e dy drejtorive do të krijonte efekte pozitive dhe së paku nuk ka pasur një debat me të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe mbarë opinionin e gjerë. Mendimi i jonë është që këto dy drejtori nuk bën të shuhen në asnjë mënyrë, por është e drejtë e pozitës që ta bëjë punën e vetë.

Fehmi Sylejmani-fjala e kryetarit i cili doli disa herë në foltore ishte mjaft bindëse dhe ishte reale dhe e vërtetë të cilën edhe unë e përgëzoj dhe përshëndeti. Mirëpo te ndryshimi i statutit nuk jam në dakord për arsyet të cilat i tha edhe Sahit Abazi, sepse nuk janë bindëse. Nuk janë bindëse dhe vërtetë nuk na kënaqin që ta bëjmë një ndryshim në paket edhe pse në disa pika pajtohemi plotësisht. Unë i kam edhe disa vërejtje e të cilat duhet t' i shikojë edhe njëherë komisioni.

Neni 6 faqe 2 te neni 14 të statutit bazë paragrafi 4 fjala “apo” zëvendësohet me lidhëzën “dhe”. Unë nuk jam gjuhëtar, por i dalloj këto dy shprehje. Kur themi “dhe” është urdhërore dhe aty përfundon gjithçka. Këtu është kryetari dhe Kuvendi, nuk mundet në asnjë vendim Kuvendi nëse nuk është edhe kryetari. Unë e këshilloj edhe njëherë komisionin që ta shikojë mirë, sepse nuk mundet dhe nuk duhet të jetë kështu? Te neni 22 faqe 4 ku thotë” fjalja e qeverisjes së pushtetit”, zëvendësohet me ‘përfaqësues dhe vendimmarrës”! Edhe këtu mendoj se duhet shikuar edhe njëherë. Të njëjtën faqe e kemi Komiteti për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Çështje Gjinore, por me sa e kuptova unë Arben Mehmeti është heq çështja gjinore.

Te Komiteti për Bashkëpunim Ndërkufitar kërkoj që të epet një shpjegim shtesë për këtë komitet. Për Komitetin për Barazi Gjinore, nuk kam asgjë kundër, por mendoj se nuk duhet të jetë.

Te neni 32 faqe 5 “vendos për “ dhe me fjalën “propozon dhe” duhet pasur dy dallime që duhet pasur kujdes. Te faqja 6 i kemi drejtoritë dhe mendoj se Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, duhet t’i shtohet edhe “Emergjencë” Plotësisht pajtohem edhe ne se këto dy drejtori të cilat mendohet se duhet të shuhen për neve janë të papranueshme. Unë nuk kam më tepër, por po e shtoj edhe një se Drejtoria e Inspeksionit është kujdestare e të gjitha drejtorive, mund të ketë reformime, por të shuhet është e papranueshme. Gjithashtu edhe Drejtoria për Sport duhet të fuqizohet edhe më shumë dhe jo të shuhet. Mandej te njësitë ; Njësia për të Drejtat e Njeriut duhet të jetë në tërësi jashtë Kuvendit, ne nuk kemi kujt t’ i ankohe mi nëse kjo është brenda Zyrës së Kryetarit. Kjo është e papranueshme dhe juridikisht jo në rregull.

Nevzat Isufi- ne kemi debatuar edhe në KPF, po më vjen si e çuditshme se këtu qenka shtuar edhe Komiteti për Barazi Gjinore. Ky komitet nuk është propozuar dhe as nuk kemi votuar dhe nëse nuk ka qenë kështu le ta demantojnë kolegët. Nga anë përmbajtjesore përpos vërejtjeve tjera teknike, në përmbajtje i bashkëngjitem mendimit të kolegut dhe mendimit të pjesës tjetër të opozitës. Nuk na është elaboruar në asnjë mënyrë se si do të jenë më efikase këto organe nëse i ndërrohet emri. Gjithashtu deri tash nuk e kemi dhënë asnjë pikëpamje financiare dhe as në pikëpamje të efikasitetit të punës. Disa sektorë janë liruar që nga fillimi dhe në fushatë partia e juaj e ka fituar qeverisjen dhe rininë e ka pasur si fjalë goje prioritet. Me vetë faktin që nga fillimi rininë e kemi lënë pa drejtor, kjo tregon se e kemi neglizhuar në një farë forme.

Disa institucione që lidhen me kulturë siç është Teatri, SHKA-të e dimë që një pjesë e këtij stafi ka mbet me muaj të tërë pa paga tregojnë se kjo kategori në një farë forme ka qenë e anashkaluar dhe jo e trajtuar si duhet. Mirëpo tash në këtë formë shkohet në këtë drejtim. Nuk kemi zvogëlim të numrit të komiteteve, sepse edhe këtu ka një implikim buxhetor, por tash me rritjen e numrit të zyrave dhe njësive në kuadër të Zyrës Kryetarit edhe këtu rritet kostoja buxhetore. Edhe për këtë rast nuk keni dhënë sqarime dhe pse patjetër po u dashka të veprohet kështu? Pajtohem me atë që u tha nga kolegu se Njësia për të Drejtat e Njeriut, dikur ka ekzistuar Këshilli për të Drejtat e Njeriut dhe Avokati i Popullit do të jenë institucione të pavarura dhe nuk kemi një zyrë qendrore të drejtave të njeriut, por brenda Komunës ka nën zyra për të drejtat e njeriut, por nuk kemi zyrë të veçantë. Nëse unë kam një problem. Dhe përsëri duhet të ankohe mi te Zyra e Kryetarit, kjo është e pa kuptimtë, por ankesat duhet të paraqiten aty ku duhet.

Edhe te Zyra për Bashkëpunim Ndërkufitar për të cilën zyrë nuk e kemi definuar se çfarë roli ka ky komitet, prandaj do të ishte mirë që ta ne epen sqarime shtesë.?

Pasi që Statuti është dokumenti më i rëndësishëm, unë po ndalem te disa gabime të cilat duhet të përmirësohen në aspektin gjuhësor, kurse në aspektin juridik duhet të merrem juristët.

Te neni 21 te fjalja e dytë thuhet:” organet komunale obligohen që t’ i informojnë qytetarët me shkrim”, këtu duhet një ndërrim të fjalëve dhe duhet të thuhet:” qytetarët duhet të informohen me shkrim lidhur me kërkesat e tyre”. Një pasues në fund : “duke iu lejuar” iu lejuar është gabim gjuhësor. Te neni 23 : Kuvendi i Komunës e miraton”, nuk ka nevojë të jetë “e” në mes.

Mandej kur thuhet decidivisht 2/3 nuk ka nevojë të thuhet “ së paku” Te neni 32” emërimi i tyre do të bëhet”, duhet të jetë “bëhet nga KK”. Fjala paragrafë në shumës shkruhet me “ë”. Fjala anëtar shkruhet pa “ë” (vërejtje fjala anëtar në njëjës shkruhet pa “ë”, kurse shumës me “ë” Te neni 37 –kompensimi, duhet të thuhet “paguhen”, mandej lartësisë e kompensimit, duhet të thuhet shuma e pagesës.

Bujar Nevzadi- unë kam filluar të topitem për mënyrën se si po udhëheq seancën, por nëse kryetari ka takim me ambasadorin le të shkojë, neve na jep 1 orë pushim dhe kthehet na jep sqarime. Nuk ka arsyetim të mjaftueshëm nga kryetari, sepse kjo është përgjegjësi e kryetarit. Unë e kam thënë edhe në KPF, ne do ta votonim statutin po të na bindte kryetari për këto ndryshime. Ne nuk jemi të interesuar për ta penguar programin e kryetarit absolut. Mirëpo e vërteta qëndron diku tjetër! Shuarja e Drejtorisë së Inspeksionit ne si grup dhe unë si individ, me vetë faktin se kryetari nuk e tha asnjë fjalë se pse iu ka arrestuar drejtori i Inspeksionit dhe nuk e pa të arsyeshme asnjë fjalë ta thotë për arrestimin e drejtorit të vetë, kjo flet shumë. Asnjë fjalë kryetari nuk e tha për ngrohje të nxënësve nëpër shkolla, kjo është aktuale në tërë Kosovën. Këtu nuk pajtohem, unë nuk dëshiroj ta shoh kryetarin e Komunës jo vetëm të LDK-së, por edhe kryetar timin, partisë sime dhe të gjitha partive dhe mbarë qytetarëve. Unë jam i gatshëm për të debatuar nëse kryetari nuk ka kohë, ia jepni fjalën kryetarit vazhdoni, aproveni statutin dhe ecni përpara.

Riad Rashiti- unë i kam vetë disa pyetje dhe nëse kryetari i Komisionit ka mundësi për të dhënë përgjigje: e para është te neni 17 i Statutit bazë neni 7 është propozuar që fjalia” nën kryetari dhe komitetet”, zëvendësohet me fjalinë “komitetet dhe komisionet”. Unë nuk e kuptoj pse është hequr fjala ”nënkryetar”? E dyta te neni 20 thuhet duke përfshirë edhe organizatat jofitimprurëse të komuniteteve të fshihet”, unë mendoj se nuk duhet të fshihet kjo, por duhet të përmirësohet. Duhet të jetë “ duke përfshirë edhe organizatat joqeveritare dhe shoqërinë civile”

Te neni 25 propozimi i ndryshimit të paragrafit të statudit bazë thuhet pas fjalisë shtohet teksti:” në mungesë të kryesuesit të Kuvendit, mbledhjen e kryeson anëtar i më i vjetër i KK-së” Unë nuk e di cila është arsyeja e këtij propozimi? A nuk do të ketë zv/kryesues në të ardhmen, prandaj kërkoj sqarim pse është hequr zëvendësimi i kryesuese në mungesë.

Te neni 27 i cili ka të bëjë me ndryshime të tjera të komiteteve, unë propozoj që të jetë edhe një komitet tjetër dhe të quhet: Komitetit Konsultative për Persona me Aftësi të Kufizuara.

Për këtë që po e them është rekomandim dhe udhëzim Administrativ i MPL-së e cila iu është drejtuar të gjithë kryetarëve të Komunës më 26 mars e cila rekomandon që të themelohet ky komitet në kuadër të KK.

Shuarja e Zyrës së Avokatit të Komunës për mua kjo është e paarsyeshme dhe e dëmshme për mbrojtjen e interesave të Komunës së Gjilanit. Gjithashtu edhe shuarja e zyrës për shërbim me qytetarë është e papranueshme, kurse është punë e mirë që komisioni nuk e ka shuar Zyrën për Informim, sepse në propozimin e parë nuk ka qenë e përfshirë.

Te njësitë; Njësia për Kulturë, Rini dhe Sport, propozoj që t’ i shtohet edhe një shtesë: Njësia për Teatër, Kulturë, Rini dhe Sport.

Komitetin për Preshevë, Medvegjë dhe Bujnaoc ne e përkrahim, por ne mendojmë se duhet të quhet ndryshe dhe të jetë: Zyra për Bashkëpunim Ndërkufitar, sepse me këtë emërtim i përfshin edhe komunat e tjera fqinje.

Serdjan Mitroviç- e nderuara kryesuese unë nuk do të kem mundësi të jap vlerësime, sepse nuk e kam bërë analizën e statudit për arsye se nuk e kam marrë projekt –propozimin me kohë. Për këtë arsyeje mendoj se është e drejta ime në votim. Për këtë arsyeje unë propozoj që kjo pikë e rendit të punës të shqyrtohet në seancën e radhës. Unë në seancën e radhës me siguri do të jem për ndryshim të statudit, por duhet të më epet mundësia dhe të epet kohë me gjatë për ta analizuar.

Propozoj që të shtyhet kjo pikë e rendit të punës deri në seancën e radhës.

Lutfi Haziri- pas debateve të juaja, unë jam i interesuar që dokumentin më të lartë siç është Statuti i Komunës, është kushtetuta e Komunës ta harmonizojmë deri në pikën e fundit në mënyrë që të jetë dokument i yni i përbashkët. Mirëpo mundësisht ky dokument në të ardhmen edhe mos të bëhet subjekt i ndryshimit kushdo që të jetë kryetar.

Jam i interesuar nëse ka palë nëse ka grupe dhe qytetarë nëse nuk janë të sigurt në atë që ne po ofrojmë jam gatshëm të ofroj mundësi dhe se kryetari i Komisionit që e ka udhëheq procesin mendon se duhet t' i japim kohë, për terminologjitë, rolet, funksionet dhe ta përfundojmë këtë çështje. Mirëpo është mirë të dihet nëse sot nuk jeni në gjendje, a dëshironi nesër këtë pikë të rendit të punës ta zgjidhim problemin në mënyrë që të sqarohemi.

Sa i përket Drejtorisë së Inspeksionit janë shumë arsyeje, sepse në këtë 9 muor është bërë performanca e kësaj drejtorie, roli i saj si strukturë e veçantë, koordinimi inspeksionit dhe shumëçka që lidhet me zbatim të detyrave dhe ju si grupe të këshilltarëve po paraqitni lista që ne i kemi nxjerr si zyrtare, ka munguar efikasiteti, ka munguar mekanizmi i cili nuk e ka zbatuar detyrën. Për këtë arsyeje duhet ta gjejmë një rrugë tjetër më efikase e cila krijon mundësi që inspeksioni ta kryejë detyrën e vetë. Kemi deshtë la largojmë obligimi nga një autoritet, nga një drejtor dhe për t' i bartë inspektorët sipas detyrës në sektorët e vetë. Ndërtimet të shkojnë në Urbanizëm si sektor i veçantë dhe drejtori i Urbanizmit e ka përgjegjësinë në të njëjtën kohë. Në këtë mënyrë secili inspektor shkon në sektorin përkatës, kurse një kategori e inspektorëve i takon qeverisë.

Te kultura arsyeja është krejt tjetër, motivi është krejt tjetër dhe ne sipas ligjit nuk kemi mundësi t' i japim terminologji tjetër. Kultura dhe sporti duhet të ndahen nga varshmëria politike, sepse subvencionet që janë dhënë këtë vit vetëm për 9 muor janë më të mëdha se për 1 vit që janë dhënë vitin e kaluar. Po bëhen harxhime nga subvencionet e drejtpërdrejta, por jo të kontrolluara 100% nga një zyrë. Problemi i dytë është se miliona euro që nga viti 2007 nuk janë mbyll subvencionet , janë para të pambyllura. Ne kemi kërkuar nga Drejtoria e Buxhetit që të bëjë mbylljen e subvencioneve duke i kushtëzuar gjithë ata që dëshirojnë të marrin subvencione nuk kanë mundësi të thithin mjete për pa i mbyll subvencionet, çfarëdo kategorie që të jenë, teatër, klub sportiv apo shoqatë qeveritare apo kategori tjetër e cila merr subvencione. Ndarja e buxhetit të qartë për një kategori si p.sh për rininë. Në janar duhet të dihet sa mjete harxhon rinia për një vit e ka shtëpinë e rinisë e ka shtëpinë e tyre e bëjnë menaxhimin e politikave, e bëjnë menaxhimin e mjeteve dhe pavarësohen nga kërkesat çdo mujore për t' i ndarë subvencion.

Ne mendojmë për ta dekoncentruar t' ia përshkruajmë detyrat, t' i përshkruajmë angazhimin dhe t' ia lejojmë buxhetin dhe ata vetë të menaxhojnë me buxhetin.

Pas fjalës së kryetarit, kryesuesja në ora 13.15 minuta i liron anëtarët e Kuvendit në pushim 60 minuta.

Në ora 14.35 minuta seanca i fillon punimet

Së pari kryesuesja kërkon që të vërtetohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit.

Nga ana e sekretarisë u konstatua se në vazhdim të punimeve të seancës ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit.

Valentina Bunjaku –Rexhepi – kryetari i Komunës i dha sqarimet dhe mendoj se kryetari i Komisionit statutar, z. Arben Mehmeti do t' i jap përgjigjet në pyetjet e parashtruara

Arben Mehmeti- propozimet të cilat janë nga anëtarët e Kuvendit, ato të cilat nuk janë në kundërshtim me rregullativën ligjore, ato do të inkorporohen, kurse çështjet gjuhësore ato do t' përmirësojë lektori. Po ashtu edhe çështjet teknike i rregullojmë me Zyrën Ligjore.

Propozimin që e dha Riadi për Komitetin për Persona me Aftësi të Kufizuara, ne e propozojmë, por varet se a do të votohet? Mirëpo unë mendoj se shefat e grupeve kuvendare duhet ta bëjnë 5 minuta

një konsultë dhe përfundimisht ta marrim një qëndrim, pastaj rikthehemi këtu dhe vazhdojmë me punë.

Valentina Bunjaku –Rexhepi- shefat e grupeve kuvendare të dalin në konsultim për 10 minuta në ndonjë zyrë afër sallës së Kuvendit.

Valentina Bunjaku –Rexhepi- pas 10 minutave shefat e grupeve nuk u pajtuan, atëherë neve na mbetet për ta hedh në votim variantin të cilin e ka propozuar Komisioni statutar.

Bjaram Hasani – te neni 21 ku është te statuti i vjetër 41, 42, 44 që shndërrohen dhe formulohen si në vijim:”organet komunale obligohen që t’ i informojnë qytetarët me shkrim lidhur me kërkesat e tyre duke komunikuar drejtpërdrejtë në gjuhën e tyre” mendoj se duhet të jetë në gjuhën zyrtare.

Te neni 24 në nenin 49 paragrafi ku thuhet tre, duhet të jetë paragrafi dy i statutit bazë të nënparagrafit 2.1. Unë pajtohem plotësisht me ndryshimin e statutit dhe e kisha ndarë pjesën e parë ku ka punuar komisioni dhe i ka eliminuar disa gabime në terminologji.

Për pjesën tjetër të organizmit të Administratës, ne duhet t’ i japim hapësirë kryetarit që të veprojë ashtu si kërkon ai, sepse përgjegjësinë më të madhe e ka vetë kryetari i Komunës.

Riad Rashiti- unë edhe njëherë po e përsëris edhe njëherë dhe në statut të jetë edhe Komisioni për Persona me aftësi të Kufizuara, është obligim, është rekomandim dhe është e nevojshme që këta persona ta kenë komisionin në KK.

Arben Mehmeti- u tha edhe më herët se nuk kemi të bëjmë me shuarje të drejtorive, kur është fjala për modifikim dhe i shtohet vlera njërive. Menaxheri për Kulturë, Rini dhe Sport e ka një përgjegjësi më të madhe profesionalisht se p.sh drejtori i një drejtorie. Propozimi i Riadit kjo është

çështje e koncenzuesit që mund të jetë pjesë e statutit, por pasi ata e kanë qëndrimin kundër ata vetë nuk po e pranojnë këtë modifikim të statutit. Trajtimi i kësaj kategorie është përgjegjësi e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Ne si komision e kemi kryer punën tonë dhe nuk kemi mundësi të rikthehemi në fillim, sepse është humbje kohe, prandaj unë propozoj që të hidhet në votim me një ndryshim që Drejtorisë për Shërbime Publike i shtohet edhe infrastruktura, por edhe te komitetet konsultative hiqet edhe fjalia konsultative. Unë propozoj që në këtë formë ta votojmë dhe të ecim më tutje.

Sahit Abazi- së pari me PDK-në as Arbeni, por askush nuk mund të bëjë pazar dhe nuk kam besuar që Arbeni është aq cinik në elemente politike. Nuk ishte tendencë as e Riadit dhe e askujt që të bëjmë pazar ne që ta propozojmë një komitet, kurse ne t’ i votojmë ndryshimet në statut. Mos e përktheni kështu se është keq. Ky ishte një propozim serioz për një temë të ndjeshme!

Ne nuk mund të pajtohemi me shuarjen e drejtorive, ky është qëndrim i yni politikë, por mos tentoni që me një propozim të singertë njerëzor të bëni pazar politik!?

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të deklarohej se kush është për aprovim të pikës 2.3 të rendit të punës?

Aprovohet pika 2.3 e rendit të punës: Statuti për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Gjilanit 01- nr.53125 të datës 11.11.2011, me 24 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 10 ishin kundër, një anëtar nuk ishte në sallë, por aprovimi është bërë me vërejtjet të cilat janë në pajtim me ligjet në fuqi.

2.4-Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Gjilanit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2013

Valentinë Bunjaku-Rexhepi- në emër të grupit për të debatuar për këtë informatë e ftoj Zijadin Maliqin dhe besoj se opozita do të q qëndrojë në sallë.

Zijadin Maliqi- në këtë rast nuk është qëllim që të akuzohet askush, por qëllimi është që të paraqiten edhe anët pozitive, por edhe të metat me qëllim që të përmirësohen dhe të bëhet një punë sa më e mirë.

Ky raport është i vitit 2013, do të thotë i qeverisjes së kaluar për të cilin do t' i them disa fjalë në vija të trasha. Sa i përket pasqyrave financiare është dhënë një opinion pozitiv nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm dhe pasqyrat financiare pasqyrojnë një pikëpamje të drejtë në të gjitha aspektet materiale. Për këtë arsye vlerësimi i pasqyrave financiare nga ana e Auditorit është opinion i pamodifikuar, me theksim të çështjes, do të thotë se janë thënë vërejtje të mëtejme !

Mirëpo në vijim Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka dhënë një numër bukur të madh të vërejtjeve gjatë punës së vitit 2013. Së pari ka vërejtje për mos adresim të rekomandimeve, do të thotë mos plotësimin e rekomandimeve të cilat janë dhënë nga Zyra e Auditorit, se pse prej 18 rekomandimeve të cilat janë dhënë, vetëm 4 janë adresuar plotësisht, 7 (shtatë), pjesërisht , kurse 7 (shtatë) nuk janë prekur fare. Këto lëshime nuk janë vetëm të një viti, por janë të disa viteve e të cilat rregullisht janë dhënë. Vërejtje tjetër është ndërrimi i destinimit të mjeteve financiare dhe theksohet se nga investimet kapitale është paguar një shumë e mjeteve mbi 19mijë € për subvencione dhe mbi 2 mijë e 800 € për mallra dhe shërbime, do të thotë pa vendim të Kuvendit është ndërruar destinimi i mjeteve, e që është në kundërshtim me ligjin. Vërejtje tjetër është mos regjistrimi i pasurisë (këto raste nuk mund të gjitha t' i gjej auditimi), por merren mostra dhe në bazë të atyre mostrave janë nxjerr këto të gjetura. Mos regjistrimi i pasurisë, ka vërejtje te objektet shkollore në vlerë prej mbi 3 milion e 700 mijë €, të cilat nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël dhe nuk janë paraqitur në pasqyrat vjetore financiare. Vërejtjet më të mëdha janë dhënë në Zyrën e Prokurimit siç janë: pagesat e organeve mbikëqyrëse dhe i komisionit për pranim teknik, përmes operatorëve ekonomik. Tjetër vërejtje është vonesat në kryerjen e punëve (nuk është theksuar se kush është fajtor për vonesë të kryerjes së punëve), sepse ka projekte të cilat kanë zgjatur me vite dhe nuk kanë përfunduar. Tjetër vërejtje është se ka raste kur menaxheri i projektit ka qenë edhe kryetari i organit mbikëqyrës. Tjetër vërejtje është se formimi i kompanive, dy kompanive, brenda një kompanie të cilat marrin pjesë në tender, por me dokumentacion të njëjtë. Mandej lidhja e kontratave pa zotim të mjeteve e që është në kundërshtim që ka krijuar dhe krijon obligime e të cilat janë bartur edhe vitin e ardhshëm. Vërejtje tjetër është pagesa e subvencioneve për pa e zbatuar Rregulloren përkatëse për subvencione, sepse ka disa raste që mbi 2 mijë € i ka paguar vetë kryetari pa e marrë pëlqimin nga Kuvendi. Ka vërejtje në kontrollin e punëve nga menaxhmenti i lartë i Komunës, ka vërejtje në drekat zyrtare, sepse nuk dihet për kë është dhënë dreka zyrtare, sa pjesëmarrës janë në dreka zyrtare dhe qëllimi pse janë dhënë ato dreka?

Gjithashtu ka vërejtje edhe për pranim të punëtorëve pa konkurs publik e që e paraqet si një rrezik në buxhetin e Komunës. Në fund vërejtja më e madhe është te obligimet të cilat i ka krijuar Komuna në kundërshtim me ligjin. Ka edhe një numër mjaft të madh të vërejtjeve, por unë nuk u zgjerova shumë, por këto lëshime janë për pushtetin për t' i analizuar dhe t' i adresojë si duhet rekomandimet të cilat janë dhënë.

Fehmi Sylejmani- unë po e them se këtu na mungon një raport (raporti auditimit) i cili fakt po ndodh shpeshherë që unë po e ngris dhe vazhdimisht e kam thënë se çdo pikë e rendit të punës duhet ta ketë komplet përmbajtjen, por përsëri kemi mungesë të raportit.

Sadri Arifi- ne të gjithëve materialin ia kemi dërguar në kopje elektronike, sepse ka kaluar koha e letrave, por besoj se edhe ju do të bindeni se mënyra e komunikimit me letra është e demoduar. Ky është shpenzim i madh, sepse raporti i posedon 100 faqe.

Fehmi Sylejmani- unë pajtohem plotësisht me z. Sadriun, por ne ende nuk kemi marrë llap-topët, atëherë do të ishim shumë në nivel, por derisa nuk pajisemi me llap- topët, duhet të na e dërgoni materialin në kopje fizike?

Riad Rashiti- së pari nuk e pata të qarta sepse e tha kryesuesja se ne kemi ikur nga seanca dhe përsëri po ktheheni në temë dhe fjalë të kota. Ne nuk kemi nevojë të ikim dhe nuk bënë të akuzosh askënd pa argumente, sepse tash do ta dëgjosh se si ke punuar ti kur ke qenë në qeverisje. Ky raport është pasqyrë e një pune të mirë të cilën e ka bërë qeverisja e PDK-së për gjashtë vite. Auditori i Përgjithshëm në vlerësimin që e ka dhënë vlerësimin e ka dhënë pozitiv për të gjitha raportet financiare të cilat kanë ndodhur e të cilin raport z. Rashiti e lexon. Unë nuk mund të bëjë krahasim me punën e qeverisjes së juve, sepse ende nuk ka përfunduar viti 2014, por po mundohem për ta bërë një krahasim me raportin e 2007.

Në vitin 2013 raporti i auditimit nuk thotë se ka pasur keqpërdorime, e që për ne është shumë e rëndësishme, askund nuk thuhet se janë bërë tejkalime ligjore, askund nuk thuhet se ka tenderime marrëveshje ashtu siç ka pasur më 2007. Ne për këtë raport të vitit 2013 jemi krenar, sepse askund nuk vërehet se kemi keqpërdor buxhetin.. Opinioni i auditimit për vitin 2007 thotë kështu: “ për mendimin tonë pasqyrat nuk paraqesin pikëpamje të drejtë dhe reale në të gjitha aspektet të pozitës financiare të Komunës së Gjilanit, më 31 dhjetor të vitit 2007”.

Në vijim të fjalës së tij z. Rashiti dhe edhe shumë vërejtje tjera për vitin 2007.

Zijadin Maliqi-kjo mënyrë e punës më duket se nuk është normale, sepse të flitet për 2006 dhe 2007 ku është dhënë raport dhe janë dhënë vërejtje nuk është tash korrekte të përsëriten. Edhe sot këto vërejtje janë gjet, por qëllimi kryesor është në të ardhmen këto vërejtje të përmirësohen.

E keni rastin vitin e ardhshëm për të dhënë vërejtje, për të kritikuar dhe dhënë sugjerime pjesë të cilave do të jem edhe unë. Më 2006-2007 dihet se ka qenë tjetër gjendje, sepse atëherë ka qenë buxheti i konsoliduar i Kosovës me 400-500 milion €. Zyrën e Prokurimit e kam udhëheq vetë në atë kohë dhe jam i sigurt se asnjëherë nuk është punuar më mirë.

Duhet të dihet dhe të mësohemi se gjithmonë krahasimet bëhen në krahasim me një vit paraprak dhe me 7-8 vite prapa! Vërejtje ka pasur edhe atëherë, janë përmirësuar, por edhe sot atë qëllim e kemi që të gabojmë sa më pak.

Avdyl Aliu- nuk mund të fshehët askush pas ndonjë fakti, sepse nuk mundet! Kjo është sikur t’ i fshehësh të hollat në një xham të tejdukshëm. Nëse themi se Auditori i Përgjithshëm, është që të kontribuojë në menaxhim të shëndosh menaxheria dhe financiar me paranë publike dhe në këtë mënyrë ta kemi një besim te shtresat e gjëra do të thotë që t’ i sigurojmë taksa paguesit edhe palët e tjera të interesit se para e tyre po shpenzohen drejt dhe mirë, atëherë mund të themi se Zyra e Auditimit të Përgjithshëm të Gjilanit ka dështuar në arritjen e këtij misioni.

Duke e ditur dhe duke e parë sa negativ është ky raport, përsëri dyshoj në cilësinë e këtij auditimi? Gjithashtu është larg standardeve ndërkombëtare nga fusha e auditimit. Sido që të jetë i qet një hije shumë të zezë Komunës dhe e vë në dyshim taksa paguesin e Komunës. I vë në dyshim, sepse thonë se po keqpërdoret paraja e jonë. Jo që janë mënjanuar të gjeturat negative, por ato kanë vazhduar nga viti në vit me një trend të rritjes së të gjeturave. Ky raport është i përmbush plotë me konkludime negative të cilat i përmendi kolegu Zijadini. Komuna kishte bërë keq menaxhim të parave nga kategoria e investimeve kapitale dhe ka paguar për mallra dhe shërbime. Ka lëshime, pasaktësi, dobësi, kontrolla të dobëta si menaxhimi i pasurisë, procesi i prokurimit, përfshirja në pagesat për

organet mbikëqyrëse për projekte kapitale. Rekomandimet e vitit 2012 nuk janë zbatuar ende, kontratat janë menaxhuar dobët e të cilat kanë rezultuar me vonesat e përfundimit të projekteve dhe në rritje të vazhdueshme të obligimeve. Drekat zyrtare nuk kanë pasur dëshmi të duhura dhe të mjaftueshme për ta arsyetuar qëllimin dhe koston. Nuk është bërë asgjë në lidhje me obligimet e papaguara. Nuk është asnjë vlerësim dhe asnjë kontroll për punën e prokurimit e ku janë gjetjet më të mëdha. Ka pasaktësi në vlerësim të pasurisë së Komunës etj. Ka shumë e shumë të gjetura në këtë raport dhe thuhet se shkolla më e mirë është ajo që paguhet më së shtrenjti, sepse aty mësohet nga gabimet. Paguhet shtrenjtë, por mësohet më mirë. E mira e këtij raporti është që të na shërbejë se si nuk duhet punuar!

Izmi Zeka- unë besoj se të gjithë e dimë se çka është auditimi dhe nuk kemi nevojë t' i mbajmë ligjërata askujt këtu. Raporti ekziston, është i tejdukshëm, a ka të mira dhe të këqija, ju jepni vlerësime. Nëse ka të gjetura se diku nëse është keqpërdor buxheti, urdhëroni i keni organet kompetente. Nëse nuk ka, por unë e di që ka rekomandime prej vitit në vit. Mirëpo po i them edhe diçka se do të shihemi dhe dëgjohemi vitin e ardhshëm. Përsëri do të ketë vërejtje dhe të gjetura, sepse është e pamundur të mos ketë. Është e pamundur për pa pasur të gjetura për shkak të ndryshimit të ligjeve, për shkak të nevojave buxhetore dhe përsëri do t' i kemi të njëjtat probleme. Unë i besoj Raportit të auditimit ashtu si është, sepse auditori gjeneral është më profesional dhe i dinë gjërat më mirë se ne. Janë 13 rekomandime të vitit 2013, por mos harroni se nga vitit në vit është përmirësuar gjendja dhe ne nëse kemi gabuar në ndonjë procedurë nuk është ndonjë gabim shumë i rëndë. Ne ndoshta kemi pasur ndonjë tejkalim të procedurave, por ju mos i bëni ? Auditimi është në dobi të Komunës, ne e kemi bërë punën dhe kjo duket se si po bëhet, por ne e kemi lënë një bazë të mirë, kurse tash vazhdoni ju. Është e pamundshme të jetë i njëjtë raporti i auditimit të vitit 2013 me atë 2014. Do të iu lus mos flisni me tendencë, vazhdimisht po thuhet pushteti i kaluar, sepse kjo është bërë lodhje edhe për neve, sepse qasja nuk është e mirë. Krijoni hapësirë për një debat më të mirë, sepse nëse aty ku kemi gabuar e pranojmë, por duhet të thuhet edhe ajo që është bërë mirë. Ju i keni fituar zgjedhjet, prandaj ecni më tutje, sepse edhe për mua është mirë që në Gjilan të ecin punët në superlativ. Nuk duhet të thuhet vetëm keq e tërë ajo çka është e kaluar, sepse kjo logjikë nuk është e mirë.

Valentinë Bunjaku-Rexhepi- të falënderoj z. Zeka, sepse je themelues i PDK-së në Gjilan, prandaj të takon t' i edukosh dhe t' i disiplinosh këta kolegët e tu. Por edhe ju z. Rashiti ta kam tërheq vëmendjen dhe lexoje nenin 27 dhe 28, sepse për t' i thënë dikujt nuk din për të lexuar dhe t' thuhet dikujt ke qenë pjesë e pushtetit për pa qenë dhe për të bërë akuza të pabaza nuk tolerohet. Nuk dua koment dhe nuk dua debat, por po iu them lexoni nenin 27 dhe 28, sepse kjo rregullore është në fuqi prej ditës kur ju e keni aprovuar.

Leonorë Bunjku – zonja kryesuese të kesh kujdes në sjellje, sepse për të na edukuar dikush Izmi Zeka apo dikush tjetër nuk mundet, sepse ne nuk e kemi moshën e edukimit. Të kesh kujdes në shprehjen tënde, kjo është hera e parë që ne të tolerojmë të sillesh në këtë mënyrë!

Valentinë Bunjaku-Rexhepi- patjetër se më duhet të them kështu, sepse t' i thuhet dikujt nuk dinë për të lexuar, mandej për ta shkel rregulloren me dy këmbët askush nuk mund t'iu durojë. Plotë 5 orë zotëria po ofendon, prandaj edukata e juaj po shihet.

Riad Rashiti- kryesuese Kuvendin e ke shndërruar në cirk, ti nuk ke aspak edukatë, sepse po të kishe pasur edukatë bile pak së pari fëmijët e tu i kishe edukuar më mirë, ti nuk je askund dhe nuk je në nivel timin. Ti je larg në krahasim me mua, në fund je, nuk mundesh të ngritësh zërin në seancë të Kuvendit,

Nuk iu pëlqeu krahasimi i vitit 2007 me atë 2013, por një gjë e freskët Organi i Shqyrtimit të Prokurimit, ia ka anuluar dy tender juve, me 6.8. 2014 e ka ndaluar tenderimin e projektit për ndërtimin e trotuarit nga Shkolla Filllore "Abaz Ajeti" në Gjilan deri te Shkolla Filllore "Mulla Idrisi" në Velekicë, sepse ia keni dhënë kompanisë së juaj të preferueshme tenderin i cili ka qenë i treti për çmim më të lartë. OSHP-ja iu ka detyruar ta anuloni këtë tender me rekomandim që ta respektoni ligjin, ky është krahasim i këtij viti nuk është i 2007.

Është tjetri tender për dezinfektimin dhe deratizmin në vlerë prej 360 mijë € i cili çmim është 700% më i lartë se viti i kaluar, këtë e ka anuluar kryetari i Komunës dhe ka thënë se do të fillojnë hetimet për këtë rast. Ku janë ato hetime, ku është kryetari i Komunës sot?

Këto shekeje ligjore po ndodhnin sot, prandaj mësohuni që të mos merreni me neve, por merrni me veten, kurse ne nuk lejojmë që vazhdimisht të plasoni të pavërteta në opinion. Ju jeni larg për t' i bërë vlerësimet tona.!

Valentinë Bunjaku-Rexhepi- z. Rashiti, nuk është etike dhe morale të flasësh për familjen time, por për mua është kënaqësi, sepse fëmijët e mi janë shumë të mirë dhe shumë të edukuar, por së pari ti edukoj fëmijët e tu, por edukoje edhe veten.!

Zijadin Maliqi- nuk e di pse po tensionohen gjërat, por me ligj është e paraparë që raporti i auditorit të debatohet në Kuvend. Unë në fillim e thash se në raport duhet të theksohen edhe të mirat edhe të metat. Unë ashtu në fillim i thash të mirat te pasqyrat financiare, por nuk mund të them se nuk ka vërejtje! Unë nuk i thash askujt se dikush ka përvetësuar mjete, ka keqpërdor etj. Vërejtjet janë dhe qëllimi është që këto të përmirësohen. Nuk punohet në këtë mënyrë po i drejtohem Riadit.

Vitin e ardhshëm do të vijë raporti i vitit 2014 dhe askush nuk do thotë pse ti po i paraqet vërejtjet që do t' i jep dhënë auditori. Ato ekzistojnë dhe nuk mund t' i heq askush, nuk kam thënë asgjë më tepër se ato që i ka thënë auditori. Mua qeverisja e kaluar më ka dërguar edhe në Gjykatë më ka dërguar dhe gjërat kanë dal si është më së miri dhe ka përfunduar puna.

Nevzad Isufi- ne nuk po kontestojmë ajo që është shkruar, mirëpo po del një konstatim i saktë që vërejtjet nga viti në vit janë përsërit dhe kjo është brengosëse për të gjithë.

Si mund të ndodh që të njëjtat vërejtje përsëriten në çdo vit dhe kjo tregon se jemi të papërmirësueshëm në një aspekt. Tjetra është se ka dyshime te Auditori i Përgjithshëm, besoj se është i pa vend dhe unë ka lexuar raporte këtilla dhe më shumë iu është besuar auditorit brendshëm se sa auditorit të përgjithshëm. Nëse është kështu atëherë nuk ka qenë deshtë të ekzistojë auditori si i tillë. Nëse është kështu është dashtë që ato rekomandime të aprovohen dhe në praktikë të zbatohen. Unë mendoj se do të duhej që të kemi një detyrim që ne t' i zbatojmë rekomandimet dhe mos të jenë më rekomandime, por të jenë vendime dhe kur dikush gjobitet për të gjeturat, atëherë do t' i kishim përfill. Ne e kemi parë se kjo është përsëritje e të njëjtave gabime dhe të njëjtave struktura, qoftë nga pushteti paraprak ose ky aktual. Çështja ka mbet se si të eliminohen këto gabime, nga viti në vit, por ne vërejtjet duhet t' i pranojmë, sepse Auditori i Përgjithshëm është më i paanshëm dhe më profesional.

Me këto debat përfundoj pika 2.4 e rendit të punës e cila sipas ligjit nuk votohet

2.5. Kompensimi i borxhit në emër të shpenzimeve të rrymës dhe të ujit të shkaktuara në objektin e Feim Zylfiut sipas kontratës mbi qiranë nr. 02.14782 të datës 15.11.2010.

Sadri Arifi- kryetari i Komunës në fund të vitit 2010 përmes Drejtorisë për Shëndetësi e ka lidhur një kontratë mbi qiranë për strehim të 9 familjeve skamnore në objektin e Feim Zylfiut e të cilat kanë qëndruar gati dy vite. Gjatë kësaj periudhe këto familje pasi që kanë qenë raste sociale nuk kanë pasur mundësi ta bëjnë pagesën e rrymës dhe ujit, kurse pas dy vite ato familje janë larguar

nga ai objekt, kurse borxhi ka mbet për pa u paguar. Sipas faturave që i kemi ne për rrymë është një borxh në shumë prej 3.177, 00 €, kurse për ujë 2.350, 00 €, në total bëjnë mbi 5.531, 00 €.

Është edhe një fakt se z. Feim Zylfiu ka marrë qira, por një pjesë të qirasë për një kohë ai nuk e ka marrë në vlerë afër 7 mijë €, kurse ne i kemi dedikuar për ndërtim të një shtëpie të një skamnori të Lagjja e Spitalit. Mirëpo ky njeri ka dhënë edhe donacione të tjera dhe me këtë vërtetohet se është njeri solidar dhe mjaft humanitar.

Për këtë rast debatuan edhe Zijadin Maliqi, Nevzad Rushiti, Abdyl Aliu dhe Riad Rashti dhe të gjithë diskutuesit u pajtuan që të bëhet kjo pagesë pronarit Feim Zylfiut.

Kryesuesja e Kuvendit propozoi që të aprovohet pika 2.5

Aprovohet pika 2.5: Kompensimi i borxhit në emër të shpenzimeve të rrymës dhe të ujit të shkaktuara në objektin e Feim Zylfiut sipas kontratës mbi qiranë nr. 02.14782 të datës 15.11.2010, me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit.

2.6- Kompensimi i borxhit Organizatës së Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës sipas Marrëveshjes së mirëkuptimit 02. nr.149 të datës 29.3.2010

Sadri Arifi.- edhe për këtë pikë të rendit të punës sqarimet i dha shefi i Shërbimit të Kuvendit, z. Sadri Arifi.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkoi që të aprovohet pika 2.6

Aprovohet pika 2.6 e rendit të punës: Kompensimi i borxhit Organizatës së Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës sipas Marrëveshjes së mirëkuptimit 02. nr.149 të datës 29.3.2010, me 20 vota të anëtarëve të Kuvendit

2.7- Informatë e punës së KKSMB mars- shtator 2014

Halit Rexhepi- informatën e KKSMB-së e sqaroi drejtori për Siguri, Shpëtim dhe Mbrojtje të cilën informatë, anëtarët e Kuvendit e kanë pasur edhe me shkrim në materialet e tyre të seancës.

Izmi Zeka- un e di se si duhet të funksionojë KKSMB-ja, por më duket se kryetari i Komunës duhet ta udhëheq KKSMB-në dhe është obligative, sepse kjo nuk është çështje e dëshirës as që duhet t'ia bartim tjetër kujt. Kjo është taksativisht e rregulluar me udhëzim administrativ.

Halit Rexhepi-është e vërtetë se në udhëzim administrativ thotë se e udhëheq kryetari i Komunës ose personi të cilin ai e autorizon. Unë këtë Këshill për siguri e udhëheqë si anëtar i Këshillit, sepse më ka autorizuar kryetari.

Arben Maliqi- unë kam qenë anëtar i këtij këshilli në mandatin e kaluar, por edhe në atë mandat nuk e ka udhëheq këtë Këshill kryetari, por nënkryetari. Unë nuk shoh të keqe asgjë vetëm do ta përgëzoj, z. Halitin, sepse me përkushtim po e bën një punë të mirë dhe duhet ta ndihmojmë të gjithë këtë Këshill.

Isa Agushi- unë kam pyetje për drejtorin; sa anëtarë janë në këtë Këshill nga Komuna dhe pse nuk bënë pjesë në këtë Këshill kryetari i Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim?

Halit Rexhepi- përbërja e KKSMB-së është në bazë të Udhëzimit administrativ të MPB-së, ne iu kemi përmbajt këtij udhëzimi dhe aty janë komunitetet, bashkësitë fetare dhe disa institucione taksativisht të caktuara kush merr pjesë?

Arben Mehmeti- unë po e shfrytëzoj rastin e prezencës së zv/ ministrit të Punëve të Brendshme që të jap kontribut për ta rregulluar ndryshe këtë aspekt. Mirëpo edhe mund të mos rregullohet fare, sepse sipas këtij udhëzimi administrativ, direkt cenohet autoriteti i KK-së. Një formulë që vjen nga Prishtina për ta funksionalizuar një këshill është jo serioze dhe në kundërshtim me realitet nga komunat.

Izmi Zeka-nuk ka tolerancë, në udhëzim administrativ shkruan se këtë Këshill e udhëheq kryetari i Komunës, nuk ka mundësi askush tjetër. Për Arbenin KKSBB-të janë aspekt kushtetues dhe nuk është aspekt as i Komunës as i MPB-së. Në kushtetutë thuhet se këto Këshilla duhet të funksionojnë në nivel komunal, kurse mënyra e organizimit është çështje që e debatohet.

Halit Rexhepi- në udhëzim administrativ thuhet e udhëheq kryetari i Komunës ose nënkryetari. Edhe po e them se ICITAP-i e përcjell këtë Këshill dhe ICITAP-i për këtë Këshill ka lëvdatat më të mëdha të cilat ka mund t' i jap një KKSBB-je. Për mua është ngarkesë, por më ka obliguar kryetari dhe e udhëheq.

Kjo pikë e rendit të punës ishte informatë dhe nuk pati debatues të tjerë, por edhe nuk votohet.

Të ndryshme

Nevzat Isufi- unë në radhë të parë kam një pyetje, por edhe një këshillë. Së pari nga ju kërkoj që mos të na diskriminoni si grup opozitat dhe si përfaqësues i LVV në thirrjet që bëni për trajnim për Akademi të qeverisjes lokale me të cilin rast jemi anashkaluar, kurse shefat e grupeve të tjera kanë qenë pjesëmarrës. Po kështu ka ndodhur edhe me një trajnim tjetër, por përfaqësuesi i ynë ditën e trajnimit është ftuar për të shkuar në trajnim, prandaj kjo është joserioze.

Gjithashtu ekziston edhe një vendim i mëparshëm të cilin e përmendi kryetari, por kërkoj që atij vendimi t' i bashkëngjitet edhe kërkesa e jonë me të cilën kemi kërkuar që të gjenden lokale edhe për subjektin tonë politikë, sepse kjo është një kohë e gjatë që ne paguajmë qira.

Një çështje tjetër është ngrohja nëpër shkolla, por këto ditë është ndërmarrë një iniciativë e përkohshme, por do të duhej që të ndërmerri masa që mos të ketë mungesë të ngrohjes në shkollat tona. Gjithashtu edhe trajtimi i anëtarëve të Kuvendit duhet të jetë i njëjtë dhe nganjëherë ne dy deri në tri herë e ngrisim dorën dhe nuk na epet fjala, prandaj duhet pasur kujdes dhe zbatuar rregulloren.

Fehmi Sylejmani- në Lagjen "Dardania" ka filluar më herë asfaltimi i disa rrugëve, por ende nuk ka përfunduar për arsyeje të panjohura. Mirëpo në ato rrugë që ka përfunduar puna kërkoj një raport nga Komisioni profesional mbikëqyrës se a është bërë pranimi teknik. Gjithashtu ekzistojnë edhe tri rrugë të tjera të cilat janë pranuar, pa komisionin mbikëqyrës.

Pyetja tjetër është se çfarë antena janë vendosur në objektin 13 katesh afër sallës së Kuvendit, çfarë operatorë janë dhe kujt i shërbejnë ato antena?

Një pyetje për sport për drejtorin: cilave klube iu ka ndihmuar dhe me çfarë shume dhe çka është ndërmarrë që mos të shuhet Klubi i Basketbollit, konkurrenca e meshkujve.

Pyetje tjetër ku u tretën zyrat e Komunës te Kadastri dhe ajo përballë Urbanizmit, sepse sipas marrëveshjes me PPP-në ka qenë desh t' i takojë një përqindje e konsideruar hapësirave të Komunës. Gjithashtu ta keni në konsideratë që të na furnizoni me llap-topë, sepse vetë keni premtuar se do të na pajisni në gjysmën e dytë të vitit.

Leonorë Bunjaku- unë jam ndier e anashkaluar qysh në fillim të seancës dhe kjo nuk është hera e parë që ndodh, por përveç kësaj unë dhe kolegët e mi u ndien të ofenduar. Mirëpo shpresoj se ju si kryesuese do ta shqyrtoni dhe analizoni dhe do ta tërhiqni atë fjalë. Unë kam obligim moral dhe përgjegjësi ndaj qytetarëve të Komunës së Gjilanit e në veçanti ndaj votuesve të mi se me tërë

potencialin tim intelektual dhe moral unë kam përgjegjësi të shprehi mendim dhe të jap përgjegjësi për atë që gjendem këtu. Në fillim kërkoja dhe përsëri mendoj se çështja e arsimit duhet të jetë në kontinuitet dhe e vazhdueshme në KK. Në çdo seancë ka se çka të flitet për arsimin, nuk është e mjaftueshme nëse herën e kaluar drejtori i Arsimit ka dhënë informatë, por duhet përsëri të jep informatë në këtë seancë. Mirëpo drejtori nuk qenka prezent unë nuk kam kujt t' i drejtohem, por ndiej keqardhje ndaj atyre arsimtarëve të cilët janë të rrezikuar që të mbesin të pa punë.

Ne çështjen e Shkollës së Bujqësisë e kemi debatuar edhe në Komitetin e Arsimit, por si duket rekomandimet që i kemi marrë aty nuk janë proceduar më tutje. Edhe një çështje tjetër çështje me rëndësi është siguri i lëndëve djegëse për ngrohej, sepse ka shkaktuar probleme në mbarëvajtje të procesit edukativo-arsimor. Kjo ishte ana ime të japim kontributin tonë, të jemi konstruktiv, por t' i mohohet dikujt për ta marrë fjalën askush nuk e ka atë privilegj.

Fatbardhë Selmani- ne qysh në fillim të seancë kemi kërkuar që në pikën nën të ndryshme të diskutohet gjendja në sektorin e shëndetësisë. Kryetari i Komunës nuk qenka prezent, por as nuk kemi drejtor të Drejtorisë për Shëndetësi, nuk është as drejtori i Arsimit, por mungojnë edhe shumë drejtorë, ne nuk kemi ndonjë pyetje, sepse nuk ka kush të na ep përgjigje.

Mirëpo në emër të grupit të PDK-së në seancën e radhës pikë e rendit të punës të jetë edhe gjendja në shëndetësi.

Shukrie Rapuca- edhe unë në mungesë të drejtorit të Drejtorisë së Arsimit nuk po i parashtroj pyetjet të cilat i kam pasur në plan. Mirëpo nuk është tepër të bëhet një pyetje dhe së paku të brengosemi secili prej neve me fatin e 300 nxënësve të cilët nuk i kanë mbushur kriteret për t' u pranuar në drejtimet të cilat ata e kanë pasur dëshirën, por po paraqesin edhe një pengesë tjetër për mos përmbushjen e numrit të nxënësve në Shkollën e Bujqësisë nga i cili fakt po rrezikohen edhe mësimdhënësit e asaj shkolle.

Avdyll Ali- në lidhje me trajnimin i cili u potencua nga kolegu Nevzad, më 30 dhe 31 tetor kemi pasur ftesa për trajnim të anëtarëve të Kuvendit me Helveta Swis, programi Demos. Më 23 tetor do të thotë 8 apo 9 ditë më parë i kemi pasur ftesat në adresa elektronike dhe keqardhje e them se shumë pak iu kanë përgjigj ftesës për këtë trajnim edhe pse kemi shumë nevojë për t' i ditë obligimet dhe procedurat si anëtarë të Kuvendit. Nga 35 anëtarë, në këto trajnime kanë marrë pjesë vetëm 12 anëtarë. E dyta është që në emër të të gjithëve e përgëzoj Gjimnazin Holivudian për filmin të cilin e ka prodhuar ditëve të fundit i cili ishte një film i metrazhit të shkurtër edhe nga aspekti kohor i zgjatjes së tij, por edhe nga interesimi i shikueshmërisë nga publiku, shumë pak shikues ka pasur. Më duket se festivali i kinematografisë në Kanë është më prestigjiozi në botë i cili mbahet diku në maj, por për fat të keq Gjimnazit Holivudian i ka ikur një mundësi e tillë. Autorët i kemi parë, tash na ka mbet t' i shohim vetëm regjisorët, prandaj rendi e kërkon që ky film ta ketë emrin “dikush po lyp dru”! Kërkoj që të qartësohet kjo situatë dhe të ndërmerren masa ndaj atyre që po tentojnë ta fusin politikën në shkollë dhe t' i politizojnë edhe nxënësit.

Arben Mehmeti- edhe unë jam për atë z. Zeka të jetë një lloj edukatori politik i grupit të tij, sepse po shihet se janë jo serioz në qëndrime, vlerësime dhe qëndrime. Ka diskutime nga anëtarët e Kuvendit të grupit të PDK-së që thonë: “nuk po debatojmë për çështje, sepse nuk kemi kujt t' i drejtohem”! Do të thotë në organin më të lartë të Komunës së Gjilanit në KK i cili e ka përgjegjësinë kryesore i ik debatit për ta njoftuar opinionin dhe që janë procesverbalet zyrtare e njoftojnë opinionin.

Është mirë të jeni të edukuar ndryshe, të edukuar politikisht mos e kuptoni atë të edukoheni në aspekt profesional, sepse ne nuk kemi atë kompetencë për të kërkuar. Edukim politik iu duhet, sepse këtu po ndodhin, mospajtime, konfrontime, akuzime të pabaza. Unë personalisht po e pyes z, Zeka se a ka pasur ndonjë akuzë ofendim ose ndonjë shpifje nga unë si shef i grupit të LDK-së.

Unë e di që nuk ka pasur raste të tilla, kurse tash po ndodhin akuza, ofendime, shpifje e që për mua janë të nivelit të ulët. Ne si qeverisje duhet të jemi model sjelljeve të mira, sepse Gjilani ka qenë i tillë në të kaluarën dhe duhet të vazhdojmë me këtë traditë dhe nuk duhet t'iu vijë keq nga rezultati i zgjedhjeve. Neve na takon të flasim më shumë, na takon t'ia marrim fjalën juve, sepse ekzistojnë rregulloret të cilat e rregullojnë këtë çështje.

Nevzad Rushiti- unë po e hapi një çështje tek lagja ime në të cilën lagje e kam një kërkesë z. drejtor i Shërbimeve publike për ta rregulluar parkingun pas këtij objekti ku jemi, sepse zyrtarët e Komunës 90% i parkojnë veturat në këtë vend. Unë mendoj se nuk janë shpenzime të mëdha dhe kërkoj që sa më parë të rregullohet.

Në pikën e dytë e kam një kërkesë nga qytetarët e Dheut të Bardhë, lagja jashtë qarkores për ta instaluar rrjetin e ndriçimit, sepse është një pjesë e madhe e nxënësve të cilët udhetojnë në Shkollën Fillore" Rexhep Elmazi" dhe kanë shumë vështirësi gjatë orëve të mbrëmjes.

Keni dhënë pëlqim edhe në fshatin Çelik dhe Sllubicë, prandaj edhe këtë lagjeje ta keni në prioritet.

Imet Rrahmani- unë do t'iu informoj anëtarët e Kuvendit se kur përmendet shëndetësia gjendja nuk është ashtu në atë kontekst si po thuhet, sepse po i epet kahe në tërësi negative. Ne do të dalim para medieve edhe me fakte fizike me video dhe fotografi për situatën si kemi gjetur dhe çka është duke u bërë tash. Specifikat e shëndetësisë janë pak më ndryshe se në lëmitë e tjera, sepse kemi të bëjmë me profesionistët të aftësuar për një lëmi dhe institucionet janë të shpërndara.

Mirëpo disa njerëz po tentojnë që shëndetësinë ta kualifikojnë më keq se ka qenë, por i falënderojmë se ne fajin e vetëm që e kemi deri më tash që ne ende nuk kemi bërë reformim ose ristrukturim të kuadrit menaxhues në QKMF. Ende ne punojmë në QKMF me një ushtrues të drejtorit, por të gjitha strukturat i ka nga menaxhmenti i kaluar. Nuk po them se është sabotim, por është një, neglizhencë për të mos shkuar punët mirë. Unë ia bëj një vërejtje kryetarit që ka qenë pasiv në këtë drejtim, sepse nuk janë vendos ende njerëzit të cilët kanë elan për të punuar dhe për t'iu zbatuar programe më ambicioze që ka pasur Drejtoria për Shëndetësi.

Ne atë program e kemi të shkruar dhe me atë program i kemi fituar zgjedhjet dhe besoj që shumë shpejtë do të kalojmë edhe në fazën tjetër të zbatimit. Faza e parë veç ka filluar të zbatohet dhe unë me përgjegjësi shumë të madhe iu njoftoj që me më pak se 70 mijë €, mjete janë duke u rinovuar, QKMF në Dardani komplet. QKMF në Arbri do të intervenohet në oborr, QKMF, në Malishevë, Pogradje, por është fut në renovim edhe QKMF Dheu i Bardhë. Në "Ramiz Cernica" do të rregullohet oborri dhe rrethoja. Jemi në fazën e shpërndarjes me mjete dhe aparaturë EKG, fiziometa, mjete mobilizuese, otoskop gati në të gjitha QKMF-të komplet. Janë zotuar mjete dhe shumë shpejtë do të bëhet edhe procedura e tenderimit për aparaturë laboratorike dhe kemi të bëjmë me një aparat ultra modernë i cili do të ngrit shërbimet laboratorike në nivel të regjionit.

Me ardhjen e këtij aparati do të fillojë laboratorit edhe në Arbëri. Në këtë zotim të mjeteve është përfshirë edhe materiale harxhuese, por edhe pas disa ditëve edhe furnizimi me uniforma për punëtorë.

Unë përmenden bashkë pagesat, por unë iu them me përgjegjësi se ka pasur rëni në inkasim të bashkë pagesave për shkak të planifikimit jo real ë të hyrave për vitin që po përfundon. Nuk janë 30 e më tepër që u tha më herët, po janë mbi 17 mijë € më pak. Mirëpo kjo ka ndodhur si pasojë e mos funksionalizmit të Komisionit për dhënie të certifikatave për automjete, Fjala është për mungesë të mjekut konkretisht oftomatologut i cili profil i mjekëve në Gjilan është i vogël dhe nuk e kanë atë drejtë të marrin pjesë në dy-tri Komisione ose të lihen faksimilet nëpër zyra të caktuara dhe një njeri t'iu vulos të gjitha certifikatat, për pa i kontrolluar. Ne jemi të interesuar që t'iu bëjmë kontrollimet, por në pamundësi për ta gjetur oftomatologun nuk mund të funksionalizohet një komision i tillë i

cili do të kishte mbledh bashkë pagesa. Ne jemi të gatshëm për debate, por po theksoj se nuk jemi të kënaqur me atë çka kemi arrit, sepse këtu interferon edhe mungesa e sigurimeve shëndetësore.

Riad Rashiti- ju po akuzoni që ne po i ikim debatit, por Fatbardha e dha arsytimin pse kërkoi që në seancën e radhës të hyjnë si pika të rendit të punës këto çështje. Arsyeja është se në Komunë të Gjilanit tri drejtori janë pa drejtorë, dy janë ushtrues detyre, njëri është konflikt interesi, sepse është edhe drejtor i QKMF-së dhe i Drejtorisë së Shëndetësisë, njëri është në burg dhe nuk dihet pse është burgos, por as ju nuk na njoftuat. Kërkuam dy herë sqarime për çfarë arsyeje është burgos, drejtori i Inspeksionit, duhet të na epni një informatë. Ne nuk po dimë kujt t' i drejtohem dhe kush të na jep përgjigje? Këtu është drejtori i Kulturës që nuk ka drejtor, ku është drejtori i financave i cili nuk ka drejtor, ku është drejtori i shëndetësisë, ku është kryetari i Komunës i cili duhet dhënë përgjigje? Ju nuk po dini të përgjigjen për çështjet të cilat po i ngrisim. Nëse ka gatishmëri për të debatuar, atëherë përgjigjuni në pyetjet tona.

Pyetja e parë ka qenë pse nuk është bërë furnizimi i shkollave me derivate për ngrohje, sepse tri javë ka pasur vonesë. Pse ka ndodhur kjo avari? Ndryshimi publik paraqet rrezik edhe për nxënësit, por edhe qytetarët. Në shkolla nuk ka ujë të pijshëm, qentë endacak janë me dhjetëra që shëtisin në mëngjes në mbrëmje dhe në çdo kohë. Patëm pyetje se nuk iu janë kthyer nga 35 € qindra nxënësve të cilëve iu kanë marrë për ekskursion, por i cili është ndërprerë për shkak të një tragjedie që i ndodhi një nxënësi? Nuk po e zgjas, por po iu lus mos tentoni të provokoni situata ashtu si po bëni. Nëse mendon shefi i grupit se dikush i frikohe këtij, ne jemi këtu dhe këtu do të jemi.

Përmendja e drurit për neve është kërcënim, por drurin e keni nëse mesin e juaj dhe i keni drejtorët e juaj që dinë për të rrahur dhe nuk do të shkojë gjatë do të rriheni përsëri sikur që jeni rrahur më parë.

Valentinë Bunjaku Rexhepi- të gjitha shefat e grupeve të parive politike të cilat kanë ardhur me këto kërkesa e thash edhe në fillim e bëni një listë të përbashkët, pastaj i dërgoni në emailin tim ose shefit të Shërbimit të Kuvendit, ne do ta thërrasim një seancë të veçantë dhe të përgjigjemi në pyetjet e juaja dhe do t' i debatojmë të gjitha çështjet që iu interesojnë. Sa i përket drejtorit i cili është paraburgosur ai ka qenë drejtor i Partisë Republikane me të cilët e kemi pasur një marrëveshje dhe pse ai ka pasur mosmarrëveshje me dike dhe ka ardhur deri te konflikti fizik është çështje personale e tij.

Arben Maliqi- unë po kërkoj falje dhe duhet të mësohem të kërkojmë falje dhe në Kuvend duhet të përdoren fjalët e mirësjelljes si më fal, të lutem, a bënë etj. Ne kështu i edukojmë nxënësit, kurse vetë nuk i përdorim. Në Kuvend nuk ka nevojë t' i japim askujt edukatë politike, sepse të gjithë jemi të njëjtë. Ne duhet ta bëjmë një punë të mirë ashtu siç na ka hije. Ju lus kryesuese e Kuvendit dhe ju Riad mos t' i përdorim këto fjalë brutale dhe mos të kalojmë në inate. Fjalët që po thuhet në këtë sallë e të cilat po i dëgjojnë i madh dhe i vogël dhe kjo është për çdo keqardhje. Iu kisha lut t' i heqim nga fjalori këto fjalë të cilat e rëndojnë dike dhe ndikojnë negativisht.

Ramiz Ramadani- unë fillimisht do të përgjigjem në shqetësimin e zonjës Rapuca, sepse mendoj se shqetësimi është i drejtë dhe nuk është shqetësim vetëm i saj, por është shqetësimi përmasave shumë më të gjëra dhe i shumicës prej juve. Mirëpo ne jemi 3- 4 komuna të cilët jemi marrë këtë çështje (trajtimi i qenve endacak), por Kosova është vogël dhe është e pamundshme pa një plan nacional të zgjidhet kjo problematikë. I kemi trajtuar 300 qen e kam përsërit disa herë në këtë Kuvend. I kemi trajtuar klinikisht dhe ligjërish si parashihet sipas ligjit. Mirëpo nuk e kemi zgjidhur situatën dhe kjo është ajo pasqyra reale. Ne kemi kërkuar një minimum të mbështetjes ligjore, por ndoshta ashtu si dikush ka dëshirë që nesër të bëhet objekt i bisedimeve. Unë kam pasur Kontakt me Shërbimin e Agjensionit të Veterinës, konkretisht me Nol Kabashini i cili është shef i sektorit të mirëqenies së kafshëve. Mirëpo shefi Nol Kabashi decidivisht më ka deklaruar për shkak të serioziteti ju dhe dy komunat që i keni do ta dërgoj një grup të veterinarëve të cilët

janë të kontraktuar për eliminim me eutanazi të qenve. Unë mendoj se jemi duke u kordinaur dhe mendoj se kjo është zgjidhja. Ne i kemi caktuar lokalitetet, si është Spitali Regjional i qytetit, Shtëpia e Shëndetit, Çerdhja Iliria, Shkollat Filllore “Abaz Ajeti dhe Rexzhep Elmazi” dhe Shkolla Filllore “Thimi Mitko”. Janë zgjedhur këto shkolla, sepse në këto lokacione më tepër lëvizin qentë. Unë mendoj se të gjithë kanë kontribuar pozitivisht dhe kontributi më madh është t’i etitetikojmë zonat dhe të punojmë bashkërisht, ne jemi duke punuar.

Sokol Haziri- unë mora disa pyetje nga formacionet politike, por shërbimi ynë nuk i adresohet asnjë partie politike, sepse ne jemi në shërbim të qytetarëve të Komunës. Unë do të mundohem në çdo skaj dhe çdo pjesë të Gjilanit të ta instalojë rrjetin e ndriçimit. Nuk ka drita në disa lagje është e vërtetë, por para nuk ka! Tash më nuk është KEKU, sepse tash KECI është Kompani private, por ne do të bisedojmë edhe me këtë kompani, sepse çdo shtyllë dhe çdo orë vendoset në pronë publike dhe jo në pronë private. E dyta ofertat mbi soliter? Me plotë të drejtë është bërë kjo pyetje dhe qysh në muajin prill kur e kam marrë mandatin unë e kam bërë një shkresë të veçantë dhe i kam identifikuar problemet. Mbi soliter janë antenat kabllore Ipoko, Kujtesa, PTK-ja, por edhe radiot e ndryshme lokale të Gjilanit dhe sipas informacioneve të mia ka qenë edhe një antenë e MOB-telit të Serbisë e cili nuk është funksionale, por ka mbetur aty. Mirëpo një sqarim po e jap se kulmi ndërtesës së soliterit, nuk është pronë publike, por është pronë e përbashkët, apo bashkëpronësi e banorëve të kësaj ndërtese. Unë kam pasur kontakt dhe me banorët dhe kërkesën e kemi për t’i hequr dhe unë shpresoj se ne ndërrimin e statutit që u bë sot, do të shihni se së shpejti disa gjëra do të ndryshojnë, sepse këtu e kërkon koha. Unë për hir të korrektësisë dhe bashkëpunimit me të gjitha grupet pëllitke, unë do ta jap listën e saktë të shfrytëzuesve të këtyre antenave se kush janë dhe kërkesën kur është dërguar në adresën e caktuar.

Çështjet tjera që u shtruan për Dheun e Bardhë qëndrojnë ato që u thanë, por lagjja që është përtej qarkores ata kanë probleme të infrastrukturës të mëdha, jo vetëm ndriçimin publik, por ujësjellësin, kanalizimin, sepse është një lagje informale dhe pa plan e ndërtuar. Mirëpo aty janë shtëpitë dhe do të përpiqemi që me buxhetin e vitit të ardhshëm do të punojmë sinqerisht për çdo lagje, por duhet shikuar sa e kemi buxhetin, a kemi mundësi? Unë nuk jam nga ata që thotë se fluturon çdo gjë, por eci për tokë dhe veprojmë aq sa kemi mundësi. Mendoj se nëse kemi mundësi teknike për të vendos trafo përtej qarkores do të shikohet mundësia për instalim të rrjetit elektrik.

Bujar Haziri- z. Sylejmani ka kërkuar edhe më herët përgjigje për çështje të sportit. Unë do ta jap një shifër se mbi 67 mijë € deri më tash janë dhënë deri më sot për klubet sportive. Mirëpo kur ia shtojmë edhe 15 mijë €, për derivate për dy minibus, sepse klubet i kanë këta dy minibus, kjo shumë del diku afër 88 mijë €. Por përsëri nëse ia shtojmë edhe një shumë tjetër kësaj të cilat drejtorja i ka paguar edhe mbi 8 mijë euro obligime për mirëmbajtje të shërbimeve në stadium, kjo vlerë arrin diku në 108 mijë €. Mirëpo duhet ta kemi parasysh se ne kemi paguar me buxhet të vitit 2014, 40 mijë €, një kompanie të kontraktuar më herët, obligimet të mëparshme të viteve të kaluara për transport të klubeve dhe ansambleve dhe kjo tregon se asnjëherë klubet nuk janë përkrahur më shumë. Tek aspekti i Klubit të Basketbollit nuk është vërtetë që është shuar, por nuk bën gara në super lig për shkak të problemeve të tyre të brendshme të menaxhimit të Klubit. Komuna nuk i menaxhon klubet, por Komuna krijon mundësi, hapësira edhe i mbështet klubet, kurse menaxhimi i brendshëm është çështje e kryesisë së klubit, Kuvendit të klubit dhe këshillave të tjera që i ka klubi. Klubi nuk ka arrit t’i bëjë grup moshat të cilat i ka kërkuar Federata për çështje të brendshme dhe normalisht që Federata i ka eliminuar. Ne kemi reaguar edhe kryetari i Komunës, por edhe dhe iu kanë dhënë një afat shtesë dy javor klubit, por klubi nuk ka arrit t’i formojë grup moshat dhe kjo është ajo që ata nuk garojnë. Nuk është shuar klubi, por nuk bën gara në super lig. Nuk është vetëm ky klub që ka probleme me menaxhim, por ne kemi një plan dhe do të fillojmë me ngritjen e kapaciteteve të njerëzve që i menaxhojnë klubet, sepse janë disa forma të reja të menaxhimit.

Fehmi Sylejmani-unë e falënderoj z. Haziri, por këto informata të na i ep me shkrim dhe të na informojë cilat klube i ka ndihmuar ? Nuk po pajtohem se Klubi i basketbollit nuk është shuar, sepse në çastin që nuk merr pjesë në super lig dhe në çastin që nuk merr pjesë as në ligën e parë është shuarje. Nga kjo po shihet se nuk është gjendja e mirë e sportit, por tjetër herë na informoni me shkrim dhe më gjerësisht.

Valentinë Bunjaku –Rexhepi – në fund i ftoj të gjitha anëtarët e Kuvendit që t’ i ndihmojnë familjet pa strehë me nga një mëditje të jua. Ky është propozim i imi, sepse unë kam dhënë ndihmë, por nuk e kam publikuar shifrën. Kush dëshiron të inkuadrohet në këtë iniciativë humanitare e keni llogarinë bankare dhe çdo gjë është transparente.

Me këto debate dhe vendim, seanca e njëmbëdhjetë i përfundoi punimet në ora 17.00

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesja e Kuvendit

Valentinë Bunjaku –Rexhepi